



D R I T A

“Drita lufton kundër errësirës kur ndriçon.”

KEPLER

E PËRMUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE

Prizren • Dhjetor 2007 • Viti XXIV • Nr. 8 (159) • Çmimi: Kosovë 1€, Europë 2€, Zvicër 3\$FR, SHBA \$2.50

ETËRIT E KISHËS –
SHËN INJACI I
ANTIOKISË

FAQE 8

(Shkruan:
DON MARJAN DEMAJ)



LETËRSIA E
ATË GJERGJ
FISHTËS (IV)

FAQE 16–17

(Shkruan:
NDUE UKAJ)

UDHËTIM I KRISHTLINDJES

HYJI HYRI NË HISTORINË E NJERËZ-
IMIT, HYJI ZURI VEND NË MESIN E
NJERËZVE, ME QËLLIM QË
NJERËZIT, NJERËZIMI TË GJËJË
LUMTURINË

FAQE 7


(Shkruan:
LUZ PANUKO)



REPORTAZH:
VIZITA BARITORE
E IMZOT DODË
GJERGJI NË SHBA

FAQE 10–11

(Shkruan:
DON LUSH GJERGJI)



*Për shumë mot Krishtlindja
dhe Viti i Ri 2008!*

■ POROSIA E KRISHTLINDJES

Shpëtimtari i botës

Këtë natë rishtas dëgjojmë nëpër Kishat tona kumtin që pavarësisht rrjedhjes së shekujve, ruan të pandryshuar freskinë e vet. Është një kumt qiellor që na grish të mos kemi frikë, sepse ka shpërthyer “një gëzim i madh që do të jetë i krejtë popullit” (Lk 2, 10). Është një kumt shprese, sepse na njofton se atë natë të para dymijëvjetëve, “u lind në qytetin e Davidit një shpëtimtar, që është Krishti Zot”. (Lk 2, 11). Atëherë barinjve që kishin fushuar në kodrën e Betlehemit, sot neve banorëve të kësaj bote, Engjëlli i Krishtlindjes na përsërit: “U lind Shpëtimtari. U lind për ju! Ejani, ejani Ta adhurojmë!”

Por a ka ende vlerë e domethënie një “Shpëtimtar” për mijëvjeçarën e tretë? Është ende i nevojshëm një Shpëtimtar për njeriun që ka mbërritur në Hënë dhe në Mars dhe që përgatitet për të pushtuar Gjithësinë, për njeriun që eksploron pakufi sekretet e natyrës dhe arrin të deshifrojë deri edhe kodet e mrekullueshme të gjenomës njerëzore? Ka nevojë për një Shpëtimtar njeriu që ka shpikur komunikimin interaktiv, që lundron në oqeanin virtual të internetit dhe, falë teknologjive më moderne e më të përparura të masmediave, e ka shndërruar Tokën, këtë shtëpi të madhe të përbashkët, në një fshat të vogël të globalizuar? Paraqitet si i sigurt dhe krijues i vetëmjaftueshëm i fatit të vet, fabrikues entuziast i suksesve të padiskutueshme ky njeri i shekullit të njëzetënjëtë.

Duket, por nuk është kështu. Ende vdekjet ndodhin nga uria dhe etja, nga sëmundjet dhe varfëria në këtë kohë të bollëkut dhe të konsumimit të shfrenuar. Ka prapë që janë skllëvër, të shfrytëzuar dhe të fyer në dinjtet, ka që janë viktimat të urrejtjes raciale dhe fetare, të penguar nga mostoleranca, diskriminimet, ndërhyrjet politike dhe detyrimet fizike dhe morale në të ushtruarit e lirë të besimit fetar. Ka prej atyre që shohin trupin e vet dhe të të dashurve të vet, veçanërisht fëmijë, të martirizuar nga përdorimi i armëve, nga terrorizmi dhe nga çdo lloj tjetër dhune në një epokë kur të gjithë thërrasin dhe shpallin progresin, solidaritetin dhe paqen me të gjithë. E çfarë të thuash për ata, që, pa shpresë, janë të shtrenguar të lënë shtëpinë dhe atdheun e vet për të kërkuar diku tjetër kushte jetese të denja për një njeri? Çfarë të bëjmë për të ndihmuar ata që janë mashtruar nga profetë të lumturisë së lehtë, ata që janë të brishtë në marrëdhënie dhe të paafte të marrin përgjegjësi të përgjithmonshme për të tashmen dhe për të ardhmen, e që gjinden duke ecur në tunelin e vetmisë dhe shpesh përfundojnë skllëvër të alkoolit apo të drogës? Çfarë të mendojmë për ata që zgjedhin vdekjen duke besuar se po himnizojnë jetën?

Si të mos dëgjojmë se pikërisht nga fundi i këtij njerëzimi dëfrues dhe të dëshpëruar lartësohet një lutje sflitëse për ndihmë? Është Krishtlindje. Sot hyn në botë “drita e vërtetë që ndriçon çdo njeri” (Gjn 1,9). “Fjala u bë njeri dhe erdh në jetë në mesin tonë” (ibid. 1,14), shpall Ungjilltari Gjon. Sot, pikërisht sot, Krishti vjen përsëri “në mes të njerëzve të tij” atyre që e presin u jep “fuqinë të bëhen bijtë e Zotit”, u jep pra mundësinë të shohin lavdinë hyjnore dhe të bashkëndajnë gëzimin e Dashurisë, që në Betlehem u bë njeri për ne. Sot, edhe sot, “Shpëtimtari ynë u lind në botë”, sepse e di se kemi nevojë për Të. Pavarësisht formave të ndryshme të presimit, qenia njerëzore ka mbetur po ajo e gjithmonshme: një liri e nderur në mes të së mirës dhe të së keqes. Dhe është pikërisht aty në intimitetin vet, në atë që Bibla e quan “zemër”, ku ajo ka gjithnjë nevojë “të shpëtohet”. Dhe në epokën e tanishme post-moderne, mbase ka më shumë nevojë për një Shpëtimtar, sepse më e ndërlikuar është bërë shoqëria në të cilën jeton dhe më tinëzare janë bërë kërcënimet për integritetin e saj personal dhe moral. Kush mund ta mbrojë përveç Atij që e do aq sa të sakrifikojë në kryq të njëlindurin Bir si Shpëtimtar të botës? →

CMYK

Atë Shtjefën
Gjeçovi OFM,
një jetë për fe
dhe atdhe

FAQE 14–15

Shkruan:
Prof. dr. Jahja DRANÇOLLI

Intervista me Vinçenc Gjini

Muzika e mirë-
filltë shqiptare
e ka burimin në
muzikën kishtare

FAQE 12–13





Almari i Bazilikës së Shën Pjetrit

"*Salvator noster*", Krishti është Shpëtimtari edhe i njeriut të sotëm. Kush do ta bëjë të tingëllojë në çdo skaj të botës në mënyrë të besueshme këtë mesazh shprese? Kush do të punojë që të njihet, tutëlohet e të promovohet e mira e plotë e qenies njerëzore, si kusht paqjeje, duke respektuar çdo burrë dhe çdo grua në dinjitetin e vet? Kush do të ndihmojë që të kuptohet se me vullnet të mirë, arsye dhe moderim është e mundur që të shmanget ashpërsimi i konflikteve dhe që përkundrazi të gjinden zgjidhje të drejta? Me shqetësim të madh mendoj, në këto ditë festash, për zonën e Lindjes së Mesme, shënjuar nga kriza të rënda dhe konflikte të panumërta, dhe uroj që të ketë hapje ndaj perspektivave të paqes së drejtë dhe të gjatë, duke respektuar të drejtat e patjetërsueshme të popujve që e përbëjnë.

Lë në duart e Foshnjës së Betlehemit shenjat e rifillimit të dialogut ndërmjet Izraelitëve dhe Palestinezëve, dëshmitarë të cilave kemi qenë këto ditë dhe shpresën e zhvillimeve të mëtejshme ngushëllimtare.

Kam besim se pas aq shumë viktimash, shkatërrimi dhe pasigurie të mbijetojë dhe të përparojë një Liban demokratik, i hapur ndaj të tjerëve, në dialog me kulturat dhe besimet fetare. U bëj thirrje atyre që kanë në dorë fatet e Irakut, që të ndalojë durëa mizore që po përgjatë ven-

din dhe që çdo banori t'i sigurohet një ekzistencë normale. Lus Zotin që në Sri Lankë të dëgjohej nga palët në konflikt gulçimi i popullatave për një të ardhme vëllazërimi dhe solidaritetit; që në Darfur dhe kudo në Afrikë t'u jepet fund konflikteve vëllavrasëse dhe që të mbyllën plagët e hapura në trupin e atij Kontinenti, të konsolidohen proceset e ripajtimit të demokracisë dhe të zhvillimit. Krishti Fëmijë, Princ i Paqes, bëftë që të shuhen ato vatra tensioni që e bëjnë të ardhmen të pasigurt në pjesë të tjera të botës, në Evropë si edhe në Amerikë Latine.

"*Salvator noster*": kjo është shpresa jonë; ky është kumti që Kisha bën të tingëllojë edhe në Krishtlindjen e sotshme. Me mishërimin, na kujton Koncili II i Vatikanit, Biri i Zotit u bashkua në një farë mënyre me çdo njeri (khs. Gaudim et Spes, 22). Prandaj Lindja e Kokës është edhe Lindja e Trupit, siç vinte në dukje Papa Shën Luani i Madh. Në Betlehemin lindi një popull i krishterë, korp mistik i Krishtit në të cilin çdo anëtar është i lidhur me tjetrin intimisht me një solidaritet total. Shpëtimtari ynë ka lindur për të gjithë. Duhet ta shpallim jo vetëm me fjalë, por edhe me krejt jetën tonë duke i dhënë botës dëshmi për bashkësi të lidhura e të hapura, në të cilat mbretëron vëllazëria dhe falja, mikpritja dhe shërbimi i ndërsjellët, drejtësia, e vërteta,

drejtësia dhe dashuria.

Bashkësi e shpëtuar nga Krishti. Kjo është natyra e vërtetë e Kishës, që ushqehet me Fjalën e tij dhe me Korpin e tij eukaristik. Vetëm duke rizu-bulluar dhuntinë e marrë Kisha mund t'u dëshmojë të gjithëve Krishtin Shpëtimtar. E bën me entuziazëm dhe pasion, duke respektuar çdo traditë kulturore dhe fetare; e bën me gëzim duke ditur se Ai që kumton nuk na heq asgjë nga ajo çka është me të vërtetë njerëzore, por e çon në përmbushjen e vet të vërtetë. Në të vërtetë, Krishti vjen vetëm për të shkatërruar të keqen, vetëm mëkatin; pjesa tjetër, krejt pjesën tjetër ai e lartëson dhe e përsos. Krishti nuk na shpëton nga njerëzia jonë por përmes saj; nuk na shpëton nga bota, por ka ardhur në botë në mënyrë që bota të shpëtojë nëpërmjet Tij. (khs. Gjn 3,17)

Të dashur vëllezër dhe motra, kudo që jeni, le t'ju mbërrijë ky mesazh gëzimi dhe shprese: Zoti është bërë njeri në Jezu Krishtin, ka lindur nga Maria Virgjër dhe lindet rishitas sot në Kishë. Është Ai që ju sjell të gjithëve dashurinë e Atit Hyjnor. Është Ai Shpëtimtari i botës! Mos kini frikë, hapjani zemrën, priteni që Mbretëria e Tij e dashurisë dhe e paqes të bëhet trashëgimi e përbashkët e të gjithëve.

Për shumë mot Krishtlindjen!
BENEDICTUS PP. XVI

Porosia e Ipeshkvit për Krishtlindje 2008

"*E Fjala u bë Njeri e banoi ndër ne*" (Gjn 1,14)

Festa e Krishtlindjes është ripërtëritje e përvjetëshme e gëzimit të Kishës, e nëpërmjet saj të mbarë botës, për dashurinë që Ati e barti tek ne njerëzit, duke e mishëruar Fjalën e vet në gjirin e papërlyer të Marisë Virgjër. Me lindjen e kësaj Foshnje, Zoti filloi veprën e shëlbimit nëpërmjet miqësismit së natyrës së Tij Hyjnore me natyrën tonë njerëzore në personin e Krishtit, Shëlbuesin tonë. Zoti bëhet Njeri-Fëmijë për ta takuar, afruar dhe bashkuar njerëzimin me Hyjin dhe me njëri-tjetrin. E, "*Atyre që e pranuan u dha zotësinë të bëhen bijtë e Hyjit.*" (Gjn 1,12).

Kjo është para së gjithash festa e pajtimit dhe solidaritetit të Zotit me njeriun, veçmas me njerëz të varfër, të shtypur, të përbuzurit, të robëruar, të sëmurë, ata që pësojnë në trup apo në shpirt dhimbje e vuajtje. Në personin e Krishtit ka ndodhë *pajtimi madh* - mes Zotit dhe njeriut. Prandaj mes qiellit dhe tokës tani ka bashkëpunim, miqësi dhe dashuri të ndërsjellë. Nëse Zoti Dashuri ka marrë një hapë të tillë vetë-përbuzjes, aq më tepër, është detyrë e jona që në pëndesë dhe flajim, t'i përmirësojmë gjithnjë marrëdhëniet me Atë që na aftëson të duam dhe të vëhemi në shërbim të njëri-tjetrit. Sidomos të jemi solidarë me ata që kanë nevojë për mirëkuptimin, përkrahjen, ndihmën, shërbimin dhe bamirësinë tonë.

"*Hyjin kurrë askush nuk e pa: Biri i Hyjit - që është Hyj, një natyrë me Atin, Ai bëri që të njihet*" (Gjn 1, 18). Ne mund ta shohim e ta njohim Atë, vetëm nëpërmjet shërbimit në dashuri siç e shihet dhe e njihet e Lumja Nëna Terezë në të varfrit e saj. Edhe *ne mund ta bëjmë të pashëm Hyjin* nëpërmjet shërbimit të singërtë e vetëmohues në dobi të tjerëve pa dallim feje, kombi, race, gjinie, moshe, sepse të gjithë jemi kryekrijesa dhe kryevepra e Tij. Nëpërmjet ushtrimit të kësaj dashurie ne dëshmojmë se jemi bijtë dhe bijat e Tija, prandaj edhe vëllezër e motra me njëri-tjetrin.

Krishtlindja është festa

e familjes dhe jetës. Të gjithë e dimë që pa familje s'ka as njeri as shoqëri që përputhet me parimet dhe traditën tonë të shenjtë të trashëguar nga historia dhe familjet tona. Kjo festë është gjithmonë rast i mirë që të ripërtërihet dashuria dhe harmonia në familjet tona. Sidomos, dashuria për fëmijë dhe për të moshuar, traditë kjo që na mbajti gjallë gjatë shekujve. Kjo do të na ndihmojë që edhe tani në kushte tashmë të reja, tek ne dhe në botë, ta ruajmë dhe mbrojmë me çdo kusht vlerën e familjes dhe të jetës, si kulturë dhe qytetërim dashurie.

Kërsëndellat janë mbi të gjitha festa e paqes mes Zotit dhe njerëzimit, mes njerëzve dhe popujve të mbarë botës. Edhe sot fatkeqësisht ka ende shumë popuj që vuajnë nga robëritë e shumëfshita si varfëria, papunësia, mungesa e ujërave, si dhe nga vërshimet, tërmetet, ndryshimet klimatike, sidomos nga terrorizmi i cili kryekëput rrënon dashurinë ndaj të afërmit dhe merr jeta të pafajshme.

Sivjet Kosova është në pritjen e fundit të Krishtlindjes dhe të Vitit të Ri para hapit vendimtar të pavarësisë. Kjo e drejtë themelore dhe e shenjtë na takon edhe ne, prandaj falënderojmë Zotin që gjatë kësaj kohe të Kërsëndellave, e tërë bota e qytetëruar e cila këtë begati e shijon që moti, përgatitet të na i njeh këtë të drejtë edhe neve.

Kjo na detyron të gjithëve që të jemi sa më të përmbajtur, të matur, të qëndrueshëm, të kujdesshëm dhe të mirë, veçmas ata të cilëve populli iu dha besimin dhe përgjegjësin historike që të na prijnë në kurorëzimin e aspiratave tona shekullore.

Gjithë njerëzve vullnet mirë, besimtarëve tanë e mbarë popullit shqiptar brenda dhe jashtë vendit: Për shumë mot e më zemër të bardhë Krishtlindja!

Njëkohësisht uroj një vit të mbarë dhe të suksesshëm me hire dhe bekime gjatë 2008!

Ipeshkvi juaj,
+ Dodë Gjergji



Truporja e Shën Kollit në Kabash

Festa e Shën Kollit në Kabash

Më 6 dhjetor në kishën e Kabashit, kushtuar Shën Nikollit/Kollit, u kremtua festa e kësaj kisha. Meshën solemne e udhëhoqi Don Rrok Gjonllëshaj, famullitar i Bishtazhinit në bashkëmëshim me disa nga vëllezërit meshtarë. Ishte një ditë e ftohtë dimërore, por që nuk i pengoi besimtarët e shumë të merrnin pjesë në meshën shenjte, të ardhur nga famullitë përreth, por edhe më gjerë; kishte pleq e plaka, të rinj e të reja dhe, në veçanti, një numër i madh i fëmijëve, që e nderojnë shumë këtë shenjtë të madh, i njohur si pajtor i fëmijëve.

Vlen të përmendet se, përpos solemnitetit të ditës së festës, besimtarët e kësaj pjese, Binçë, Kabash, Letnicë dhe Stubëll, janë përgatitur duke mbajtur edhe nëntëditshin kushtuar kësaj feste, me meshë, rrëfime, devotshmëri dhe këngë të përcjella nga kori i famullisë. (Klodina Gashi)

Festa e Shën Katarinës, virgjër e martire në Pejë

Më 25 nëntor në Pejë, në praninë e qindra besimtarëve, u festua dita e pajtores së famullisë së Pejës, festa e shën Katarinës së Aleksandrisë, virgjër e martire.

Kisha e shën Katarinës në Pejë është një ndër kishat më të vjetra dhe më të bukura në Kosovë. Stili i saj klasik, buzë bjeshkëve të Rugovës, e bën këtë kishë edhe më madhështore.

Sot në veçanti ishte madhështore, sepse nga të gjitha anët e Pejës e nga famullitë tjera kishin ardhur njerëzit të festonin ditën e shën Katarinës, kësaj heroine, që me gjakun e vet e lë dëshminë e besimit të saj në Krishtin Zot.

Meshën e udhëhoqi famullitari i Novosellës, don Lush Sopi, i cili në pretkun e rastit foli për jetën dhe martirizimin e shën Katarinës. Pos tjerash, don Lushi foli për virtytet e krishtera e njerëzore që na hapin rrugën drejt Mbretërisë së Krishtit. Kurrë gjatë historisë së njerëzimit nuk kanë qenë vlerat më në krizë se sa sot, por kjo nuk guxon të na dekurajojë që të mos jetojmë jetën në përputhshmëri me ungjillin e Krishtit, Mbretit të gjithësisë. (www.kisha-katolike-gjakova.com)



*“Drita e vërtetë, që shndrit çdo njeri, erdhi në botë. ...
Atyre që e pranuan, u dha zotësinë të bëhen bijtë e Hyjit”* (Gjn 1, 9, 11)



Të gjithë lexuesve të “Dritës”,
të gjithë besimtarëve katolikë,

si edhe të gjithë njerëzve vullnetmirë në mbarë botën –
PËR SHUMË MOT KRISHTLINDJEN
dhe çdo bekim të Zotit në VITIN E RI 2008 dhe në krejt jetën
dëshiron

Unioni Rregulltar i Kosovës (URrK):

Kongregata e Salezianëve të don Boskos (SDB); Rregulli i Vëllezërve të Vegjël (francëskanët – OFM); Shoqëria e Jezusit (Jezuitët SJ); Bijat e Dashurisë Hyjnore; Bijat e Dashurisë së Krishterë (Motrat Vinçenciane); Misionaret e bamirësisë (M. C.) (Motrat e Nënës Tereze); Motrat Baziliane (Bijat e shën Makrinës); Motrat e Mëshirshme të shën Kryqit; Motrat e shën Filip Nerit; Motrat Engjëjllore të shën Palit; Motrat Françeskane të Zojes së Papërlëye.



Takimi i rregulltarëve të Kosovës

(Pejë, më 01 dhjetor 2007) Në Pejë u mbajt takimi i dytë i Unionit të rregulltarëve për vitin 2007/08 me temën: *Këngët liturgjike*, të paraqitur nga don Agim Qerkini. Tema e takimeve të këtij viti mban titullin: *Komunikimi dhe bashkëpunimi ndërmjet rregulltarëve në Ipeshkvinë e Kosovës, posaçërisht në aspektin liturgjik e katekistik*.

Afro 50 pjesëmarrës të këtij takimi, u mirëpritën nga Motrat Vinçenciane në shtëpinë e tyre. Takimi filloi me përshëndetjen e m. Franciska Kola, FDC, kryetare e Unionit të Rregulltarëve të Kosovës (URrK), si dhe me një lutje të shkurtër të Shën Augustinit, kurse më pas don Agimi na begatoi me përmbajtjen e sintetizuar të dokumenteve kishtarë në lidhje me muzikën shenjte, gje gjësisht, me këngët liturgjike. Ai vuri në dukje pikërisht ato dimensione që për ne këtu në Kosovë janë më aktuale dhe të nevojshme që të njihen e të përvetësohen. Ai na ftoi për një punë të përbashkët në përgatitjen e një kantuali që në vete do t'i mbërthente të gjitha këngët shqipe, të cilat ne rregulltarët i njohim dhe i këndojmë, për t'i bërë trashëgimi të mbarë Kishës në Kosovë. Po ashtu, u theksua nevoja e formimit të komisionit liturgjik, i cili do të vepronte në mënyrë profesionale e sidomos me prezencën e meshtarëve e motrave, të cilët do të shkolloheshin dhe specializoheshin në këtë lëmi.

Para se të fillonte Mesha shenjte, të gjithë patën mundësinë për t'u rrëfyer, përderisa në kapelë ishte adhurimi para të Shenjtërueshmit sakrament. Meshën e kremtoi don Agimi së bashku me p. Ilija Kovačević, OFM.

Në këtë takim për herë të parë morën pjesë Motrat e shën Filip Nerit, të cilat që nga nëntori i këtij viti kanë hapur bashkësinë e tyre të parë në Potërc; janë dy motra kosovare, m. Palina Marković dhe m. Rafaella Pecollaj.

M. Teuta Augustini

Anëtarët e noviciatit



Filloi noviciati i Rregullit Françeskan Shekullar në Gjakovë

Më 17 nëntor 2007, ditën e shën Elizabetës së Hungarisë (1207-1231), pajtores së RrFSh-së, me rastin e 800-vjetorit të lindjes së saj, 25 besimtarë të famullisë së Gjakovës kanë filluar vitin e noviciatit në Rregullin Françeskan Shekullar. Pas një viti ata do të japin kushte, apo premtime solemne, se do të jetojnë Ungjillin e Zotit tonë Jezu Krishtit sipas shembullit të shën Françeskut të Asizit – duke qëndruar në gjendjen e vet shekullare, secili në familjen e vet dhe në punën e vet.

Ceremonia e pranimit të tyre në noviciat u bë gjatë meshës në orën 11 në kishën e shën Antonit në Gjakovë. Kanë koncelbruar p. Anton Nua, famullitar dhe gardian i Gjakovës, asistent shpirtëror i RrFSh-së për famullinë tonë; mandej p. Marko

Semren, profesor në Teologjinë Françeskane në Sarajevë dhe atë shpirtëror i klerikëve, i cili ka ardhur në emër të Provincialatit Françeskan të Bosnës dhe i Vëllezërisë së Rregullit Françeskan Shekullar të Bosnës; si i treti koncelbroi edhe p. Lorenci, si bashkëpunëtor i p. Antonit në drejtimin e RrFSh-së së Gjakovës.

Për këtë akt solemn, grupi i kandidatëve për RrFSh është përgatitur me se një vit. Përgatitja filloi me nëntëditëshin e shën Françeskut të Asizit 2006. Pastaj mbi 40 të interesuar vinin në takime formative javore. Deri në fund qëndruan 25 vetë. Për hyrje në noviciat u përgatitën edhe me ushtrime shpirtërore treditëshe.

Në meshën shenjte, pas familisë së rastit, kandidatët e shprehën dëshirën e vet që të pran-

nohen në noviciat, e p. Marku në mënyrë zyrtare i pranoi. Si shenjë të pranimit ua dorëzoi Rregullin e RrFSh-së dhe shenjën "Tau", që është shenjë daluese për terciarët françeskanë në krejt botën.

Çka është RrFSh?

Rregulli Françeskan Shekullar (RrFSh) është Rregull i tretë, që e themeloi shën Françesku i Asizit (1182-1226), në vitin 1221 – për ata besimtarë që janë të lidhur me obligime martesore, familjarë dhe profesionale dhe nuk mund të braktisin botën dhe të tërhiqen nga detyrat e veta, megjithëse dëshirojnë ta jetojnë Ungjillin e Zotit tonë Jezu Krishtit në mënyrë të përsosur, sipas shembullit të shën Françeskut. Ata Zotit dhe Kishës i shërbejnë dhe përpiqen rreth

përsosjes dhe shenjtëritit të vet personal si njerëz shekullarë: brenda familjeve të veta dhe në vendin e vet të punës. Ndër françeskanët shekullarë janë jo vetëm njerëzit e thjeshtë familjarë, por edhe njerëz të ngritur: mjekë, profesorë, shkencëtarë, burra të shtetit – madje edhe shumë meshtarë shekullarë (meshtarë diocezanë, apo priftërinj), si edhe ipeshkvij dhe papë.

RrFSh ka traditë të populli shqiptar

Megjithëse ky Rregull në botë ekziston që nga viti 1221, ai në popullin shqiptar në kohën e sundimit turk ishte zhdukur krejtësisht. Në Shkodër është ripërtërirë më 28. 12. 1866, kurse në Gjakovë vetëm disa muaj më vonë – në vitin 1867.

Në Gjakovë RrFSh e ripërtëriu

P. Gaudens Barbiq, frat i Dubrovnikut. Punën e tij vazhduan P. Rosario, P. Emilio Gabos a Cles (i quajtur "P. Mila", themeluesi i shenjtërores së shën Antonit në Gjakovë), e pastaj fretërit shqiptarë P. Metod Mjekajsh, P. Luigi Paliq, P. Gjon Blushaj, P. Shtjefën Gjeçovi, dhe P. Lorenc Mazrreku. Duhet të theksojmë se tre prej këtyre fretërve vdiqën si martirë: P. Luigji, më 1913, p. Shtjefni, më 1929, kurse p. Lorenci, më 1943.

Sa e gjallë ishte kjo bashkësi, tregon edhe fakti se vetëm më 8 shtator 1916 P. Gjon Blushaj dhe P. Marjan Prela kanë pranuar në RrFSh 63 anëtarë të rinj! Por, mjerisht, pas Luftës II Botërore, kur komunizmi i ndaloi të gjitha organizatat shoqërore fetare, u fik edhe Rregulli Françeskan Shekullar.

L. G.

Enciklika e re "Spe salvi" e Papës Benediktit XVI

■ SHKRUAN:
Don Anton UKAJ

Në fillim të kohës së Ardhjes, Papa Benedikti XVI ia ofroi Kishës mbarë Enciklikën e re "Spe salvi" (*Të shëlbuar në shpresë*) – mbi shpresën e krishterë.

Në enciklikën e re e takojmë Papën si, gjithëherë, teolog të thellë dhe, në të njëjtën kohë, Bari të mirë dhe përgjegjës ndaj nevojave të grigjës së vet. Për reflektimet shumë të thella mbi lidhjet e shpresës së krishterë dhe fesë së krishterë, duke mos e lënë anash mentalitetin modern ndaj shpresës dhe fesë së krishterë, gjejmë një tekst shumë të thellë, i cili bazohet edhe në dëshmitarët e mëdhenj të shpresës, duke filluar nga Shën Augustini e deri te kohët shumë të afërta, siç janë ato të Shën Jozefinës Bakita, e cila u sprovua nga vuajtjet e shumta. Por ajo një ditë ia arriti te shpresa e vërtetë falë takimit me Zotin e të krishterëve. Papa citon shumë veta, të cilët pësuan padrejtësi të shumta dhe të çfarëdo lloji, por vazhdonin të jenë plot me gëzim, sepse nuk ishin vetëm, Jezusi ishte me ta. Papa merr shembull edhe njerëzit e ditëve tona, si bëc fjala, kardinalin vietnamez Van Thuan, i cili nga trembëdhjetë vitet e tij në burg, nga të cilat nëntë në izolim total... na ka lënë një libër shumë të çmueshëm mbi lutjet e shpresës. Gjatë trembëdhjetë viteve në burg, në një situatë të vërtetë dëshpëruese, dëgjimi i Zotit dhe lutja – kuvendimi me Të, bëhen për të një fuqi e madhe shprese.

Pastaj, me një mjeshtri të rrallë merr me shumë kujdes dëshminë e madhe të Biblës mbi shpresën, ku jep shpjegime duke nënvizuar se shumë herë fjalët shpresë dhe

fe janë të lidhura ngushtë mes vete. Në fakt, feja e krishterë nuk qëndron para se gjithash në pranimin e disa të vërtetave abstrakte, por qëndron në dhënien e pëlqimit personal personit të Jezu Krishtit, për të qenë nga Ai të shpëtuar e kështu të futur në bashkimin hyjnor. Shpresa e vërtetë na jepet nga takimi personal me Zotin e gjallë dhe të vërtetë përmes Jezu Krishtit.

Në nr. e 7-të Papa thekson që raporti mes fesë dhe shpresës shprehet shumë mirë në Letrën e Shën Palit apostull drejtuar Hebrenjve, në të cilën shihet qartë lidhja e ngushtë e këtij virtyti me shpresën.

Duke përdorur një tjetër pjesë të Letrës drejtuar Hebrenjve, Enciklika shpreh një kontrast mes dy bazave për jetën njerëzore, një bazë materiale, që garanton mbajtjen e ekzistencës në këtë botë dhe bazën të furnizuar nga feja, në lidhje të ngushtë me shpresën, që garanton përjetësinë.

Në faqet vijuese, me titullin "Çka është jeta e përjetshme?", Papa shpreh me një realizëm të gjallë mentalitetin aktual të shumë personave. *Jeta e përjetshme është objekt i shpresës*. Por shumë personave – vazhdon Papa – jeta e përjetshme sot nuk iu duket një gjë e dëshirueshme. Njerëzit e botës së sotshme nuk e duan jetën e pasosur, por vetëm të tashmen. Është e vërtetë që njerëzit dëshirojnë ta shtojnë vdekjen aq më shumë që është e mundur, por të jetosh përgjithmonë, pa një mbarim, kjo megjithatë do të ishte një gjë e mërziutshme e ndoshta edhe e padurueshme.

Duke u nisur nga një letër e Shën Augustinit drejtuar Probas, një e vejë romake, Papa precizon çka duhet të nënkuptohet me *jeta e përjetshme, jo një e ardhme e pafund e momenteve, por një plotësim i jetës drejtë të cilit aspirojmë*.

Përjetësia nuk do të jetë një eje e ditëve sipas kalendarit – thotë Papa – por diçka sikur momenti përplot shpëtim, në të cilin tërësia na përfaqëson neve dhe ne e përfaqëojmë tërësinë. Do të jetë momenti i futjes në oqeanin e madh të dashurisë së pafund, në të cilin koha nuk do të ekzistojë më. Duhet të mendojmë në këtë drejtim, nëse dëshirojmë të kuptojmë se çka synon shpresa e krishterë, çka presim nga feja, nga lidhja jonë me Jezusin. Këto janë fjalë ndriçuese dhe mbushin zemrën me gëzim.

Pas kësaj, Enciklika shtron një pyetje tjetër, mbi të cilën Papa rikthehet shumë herë. Ai pyet nëse shpresa është individuale. Papa përgjigjet duke thënë: "Larg të qenit individualist, shpresa e vërtetë e krishterë aspiron një shpresë bashkësie".

Në këtë rast, Papa në Enciklikë shpjegon që koncepti i shpresës së krishterë në vitet e fundit ka pësuar një evolucion negativ, që i ka rrënjët e veta të vjetra në veprën e Francis Bacon-it në fund të vitit 1500, me titullin *Novum Organum*, e cila premtoi shkencën eksperimentale dhe bëri të shpresojë në rikthimin e parajsës së humbur. Për ndërtimin e botës, asaj që duhej t'i jepte rëndësi, ishte besimi në progresin. U kuptua qartë që feja e krishterë u bë në një mënyrë e parëndësishme për botën dhe që

shpresa e krishterë u shndërrua në një shpresë individuale.

Pjesa e dytë e Enciklikës përshkruan vendet e kuptimit dhe të ushtrimit të shpresës. Përshkruhen tri vende: *Lutja si shkolla e shpresës; Veprimi dhe vuajtja si vendet e kuptimit të shpresës si dhe Gjykimi si vend i kuptimit dhe i ushtrimit të shpresës*. Shpjegimet e ofruara në Enciklikë janë një pasuri shumë e madhe dhe e mrekullueshme.

Kur flet mbi lutjen, Enciklika shfrytëzon një predikim të Shën Augustinit mbi Letrën e parë të Shën Gjonit, që ilustron lidhjen e thellë mes lutjes dhe shpresës, duke definuar lutjen si ushtrim të dëshirës, ushtrim ky i nevojshëm, sepse "zemra jonë është shumë e vogël për realitetet e mëdha për të cilat është caktuar, duhet të rritet. Të lutesh nuk do të thotë të dalësh nga historia dhe të futesh në një vend privat të vetë kënaqësisë. Mënyra e drejtë e lutjes është një proces pastrimi që na bën të aftë për Zotin e dalëngadalë të aftë edhe për njerëzit. Për ta arritur këtë qëllim, lutja duhet të jetë gjithnjë e udhëhequr nga lutjet e mëdha të Kishës dhe të shenjtërve, nga lutja liturgjike, në të cilën Zoti na mëson të lutemi në mënyrë të drejtë. Kështu do të bëhemi të aftë për shpresën e madhe, por edhe ministra të shpresës për të tjerët: shpresa e krishterë është gjithmonë shpresë edhe për të tjerët".

Vend tjetër ku ushtrohet shpresa është veprimi, sepse shpresa e krishterë nuk është 'punë boshe', por ajo të shtyn të veprosh. Shpresa e krishterë mbanë gjallë angazhimin e përditshëm dhe

jep guximin të veprohet edhe atëherë kur duket se ka humbur çdo shpresë, sepse është shpresa e madhe e cila mbështetet mbi premtimet e Zotit. Edhe vuajtja është vendi ku ushtrohet shpresa e krishterë, përkundrazi një vend i privilegjuar, sepse nuk është kapërcimi i vuajtjes e as ikja nga vuajtja ajo që shëron njeriun, por aftësia e pranimit të vuajtjes dhe e rritjes në të, për t'i gjetur domethënie vuajtjes përmes bashkimit me Krishtin, që ka vuajtur me një dashuri të pamashë për ne dhe mëkatet tona. Këtu Papa citon edhe dëshminë e madhe të kardinalit vietnamez Van Thuan, i cili për shumë vite pësoi vuajtjet e mëdha dhe gati të paimaginueshme, por falë takimit me Krishtin ia arriti jo vetëm t'i përballojë të gjitha, por edhe të mos e humbë as një herë shpresën.

Dhe në fund, Enciklika paraqet Gjykimin e fundit të Zotit si vend të kuptimit dhe të ushtrimit të shpresës, më saktesisht, që në një kahe paksa të ndryshme nga ato që pamë më parë, sepse Gjykimi i fundit nuk është një realitet i tanishëm ashtu siç janë lutja dhe vuajtja. Por Gjykimi i fundit nxit shpresën, sepse do ta eliminojë të keqen. Këtu Enciklika ofron reflektime të thella mbi problemin e tmerrshëm të së keqes dhe të drejtësisë. Pastaj jepen shpjegime të çmueshme mbi ferrin, purgatorin dhe mbi lutjen për të vdekurit.

Enciklika përfundon me një kundrim bërë Marisë, yllit të shpresës, një dialog shumë i bukur me Të dhe një lutje e mrekullueshme.





Dialogu duhet të bazohet në dinjitetin e njeriut dhe në njohjen objektive të fesë

Papa i përgjigjet Letrës së 138 burrave të urtë islamike për rifillimin e dialogut ndërmjet të krishterëve e myslimanëve.

Më 29.11.2007 nga Salla e Shtypit të Selisë së Shenjtë bë e njohur përgjigja që Benedikti XVI i jep Letrës së hapur drejtuar Atit të Shenjtë dhe prijësve të Kishave e konfesioneve të tjera të krishtera, më 13 tetorin e kaluar, me rastin e përfundimit të Ramazanit, nga një grup i përbërë prej 138 personalitetesh të shquara myslimane. Letra e të urtëve titullohet "Një fjalë e përbashkët ndërmjet Nesh e Jusb".

Përgjigja e Papës, e nënshkruar nga Sekretari i Shtetit të Vatikanit, kardinali Tarçizio Bertone, i drejtohet Princit Ghazi bin Uhamad bin Talhal, anëtar i familjes mbretërore të Jordanisë dhe kryetar i Institutit të Mendimit Islamik 'Aal al-Bayt' (Bejt), një nga organizatorët e nismës, i cili u kujdes personalisht për dërgimin e letrës. Duke falënderuar e duke i shprehur vlerësimin e tij për nismën domethënëse të grupit të shquar të personaliteteve myslimane, Papa ripohon rëndësinë e dialogut të bazuar mbi respektin e njëmendtë të dinjitetit të njeriut, mbi njohjen objektive të fesë së tjetrit, mbi shkëmbimin e përvojës fetare dhe mbi impenjimin e përbashkët për të promovuar respektin dhe pranimin e anasjelltë. Lidhur përmbajtjen e letrës kardinali Zhan-Lyi Toran, kryetar i Këshillit Papnor për Dialogun Ndërfetar, ka pohuar: "Në Letrën (e Papës), përveç vlerësimit pozitiv mbi përmbajtjen e Letrës (së personaliteteve myslimane), theksohet edhe gatishmëria e Atit të Shenjtë për ta pritur Princin Ghazi bashkë me një delegacion përfaqësues të të urtëve që e nënshkruan, duke mos përjashtuar edhe mundësinë e një takimi pune me Këshillin Papnor të Dialogut Ndërfetar – dhe vazhdon – Papa e çmon shumë shpirtin pozitiv, jo polemik, që frymëzoi tekstin. Natyrisht, pa i fshehur ndryshimet tona, Papa mendon se të krishterët e myslimanët mund të punojnë së bashku, sepse të gjithë, si të krishterët, ashtu edhe myslimanët, besojnë në një Zot të vetëm që është Provani, Krijues. (RI)

Nevoja e ungjillëzimit në kohën e sotme

Në Sallën e Shtypit të Vatikanit më 14 dhjetor, u paraqit një Notë doktrinale e Kongregatës për Doktrinën e Fesë, "Mbi disa aspekte të ungjillëzimit". Dokumenti, i miratuar nga Benedikti XVI, që ripohon nevojën e kumtimit të Ungjillit, duke shmangur rreziqet e relativizimit e të indiferentizimit fetar, u shpjegua nga kardinali prefekt i dikasterit, Ujllam Jozef Levada, së bashku me sekretarin, kryepeshkvën Anjelo Amato. Të pranishëm ishin edhe kardinali Ivan Dias, prefekt i Kongregatës për kultin hyjnor dhe disiplinën e sakramenteve.

"Kumtimi dhe dëshmimi i Ungjillit janë shërbimi i parë që të krishterët mund t'i bëjnë çdo njeriu dhe mbarë gjinisë njerëzore, të thirrur siç janë për t'u komunikuar të gjithëve dashurinë e Hyjtit, që u dëftua plotësisht në Shëlbuesin e vetëm të botës, Jezu Krishtin". Nota citon këto fjalë të Benedikt XVI, për të ripohuar, duke respektuar plotësisht lirinë fetare, të drejtën e çdo njeriu për të njohur të vërtetën që shpëton dhe detyrën për ta shpallur këtë të vërtetë, e cila i takon çdo besimtar. Dokumenti flet për një konfuzion të rritje, që i shtyn shumë njerëz të mos i binden urdhrimit misionar të Zotit, duke e shikuar si të ishte atentat kundër lirisë së tjetrit, ose sjellje intolerante. Disa mendojnë se mjafton të jepet ndonjë dëshmi shoqërore ose të ndihmohen njerëzit të jenë më shumë njerëz - e besimtarët t'i besojnë më shumë fesë së tyre. Në sa në Notë ripohohet se Kisha është e nevojshme për shëlbimin

e vërtetë, që nuk i kundërvihet faktit se Hyji dëshiron që të gjithë njerëzit të shëlbohen. Edhe pse jo të krishterët mund të shëlbohen me hirin që Hyji e jep përmes udhëve, të cilat i njeh ai vetë, Kisha nuk mund të mos e ketë parasysh faktin se atyre u mungon e mira më e madhe e kësaj bote: mundësia për të njohur fytyrën e vërtetë të Hyjit dhe për t'u bërë miq me Jezu Krishtin, e, edhe faktin, se të jetosh në errësirë, pa e njohur të vërtetën mbi çështjet e fundme, është një e keqe, ku shpesh e kanë zanafillën vuajtjet e skllavëria, nganjëherë dramatike. Sot – vijon Nota – pluralizmi i ligjëshëm i qëndrimeve ia ka lënë vendin një pluralizmi të padiferencuar, të bazuar mbi supozimin se të gjitha qëndrimet kanë të njëjtën vlerë. Përveç tjerash, respekti për lirinë fetare dhe promovimin e saj nuk duhet të na bëjnë në asnjë mënyrë indiferentë ndaj së vërtetës e së mirës. Nga ana tjetër – nënvizohet se liria fetare është një e drejtë që, për fat të keq, në disa vende të botës nuk njihet akoma ligjërisht, ndërsa në vende të tjera, nuk respektohet faktikisht.

Në frontin ekumenik, Nota nxit bashkëpunimin me konfesionet tjera të krishtera, duke i respektuar traditat e tyre, por edhe duke përjashtuar çdo lloj forme të 'konfuzionizmit'. Është fjala për të zhvilluar një dialog që respekton dashurinë dhe vërtetësinë; sjellje kjo që nuk e përjashton askënd nga përgjegjësia për t'ua kumtuar plotësisht fenë katolike të krishterëve të tjerë, pa u akuzuar për prozelitizëm. Kisha – pohon Dokumenti – nuk synon kurrfarë pushteti: dëshiron thjesht që të gjithë njerëzit ta njohin plotësisht të vërtetën e të kenë mjetet e shëlbimit, për të hyrë në lirinë e në lumninë e bijve të Hyjit. (RI)

Gjendja e sotme e Kishës Katolike në botë

Sipas Vjetarit të ri kishtar, numri i katolikëve në botë ka arritur në 1 miliard e 98 milionë besimtarë. Është rritur numri i meshtarëve dhe i seminaristëve, posaçërisht në Azi e në Afrikë, ndërsa në Evropë thirrjet për rrugën meshtarake janë në rënie shqetësuese.

Në Vjetar pasqyrohet periudha nga viti 2003 në vitin 2004. Të dhënat kryesore statistikore janë: numri i katolikëve në botë ka kaluar nga 1 miliard e 86 milionë në 1 miliard e 98 milionë, me një rritje prej 12 milionë besimtarësh e me përgjindje 1,1 %.

Prija për rritjen e numrit të meshtarëve në botë ka vijuar edhe gjatë vitit 2004. Në këtë vit numri i përgjithshëm i meshtarëve ka arritur në 404.891, një e treta e të cilëve janë rregulltarë, ndërsa dy të tretat dioqezianë. Numri i përgjithshëm i meshtarëve është rritur për 441.

Xhakonët e përhershëm, në rritje që nga viti 1978, në vitin 2004 ishin 32.324, të pranishëm posaçërisht në Amerikën Veriore dhe në Evropë, ku vërehet një rritje prej 2,5 % në krahasim me 2003-n dhe, po të marrim për bazë vitin 1978 (kur numri i tyre ishte 5.562), duhet arritur në përfundimin se numri i xhakonëve është rritur në mënyrë të ndjeshme.

Kandidatët për meshtar, dioqezianë e rregulltarë, paraqesin përgjithësisht një rritje pozitive, duke kaluar nga 112.373 në vitin 2003 – në 113.044 në vitin 2004. Shqetësimet më të mëdha në këtë drejtim vijnë nga Evropa, ku vitet e fundit rënia e numrit është bërë e ndjeshme. Ndërsa në Afrikë e në Azi vërehet një gjallërim inkurajues i thirrjeve për rrugën meshtarake. (A.J.)

Konferenca botërore për dialog ndërfetar dhe ndërcivil

Komunikimi dhe dialogu është diçka që duhet ta kultivojmë pasi komunikimi ndërkulturore, ndërfetar dhe ndërcivil është rruga drejt një bote më të mirë, thek-

soi kryeministri Nikolla Gruevski në hapjen e Konferencës treditore botërore për dialog ndërfetar dhe ndërcivil që mbahet në Ohër. "Prej Ohrit sot dhe gjatë kë-

tyre ditëve që pasojnë përfaqësuesit e bashkësive fetare botërore dhe grupeve religjioze, intelektuale dhe përfaqësues qeveritarë do të flasin njëzëri dhe do të dërgojnë porosi për

tolerancë, dashuri, paqe dhe bashkëjetesë", tha Gruevski. Konferenca, siç theksoi ai, mbahet në Ohër, kryeqendra shekullore kulturore dhe shpirtërore e Maqedonisë, vendi ku ka 365 kisha, nga një për çdo ditë të vitit, vendi ku në fillim të Mesjetës është themeluar njëri nga Universitetet e para botërore, Shën Klementi. Konferenca botërore për dialog ndërfetar dhe ndërcivil që mbahet në Ohër, është vazhdim i disa forumeve dhe tubimeve të mbajtura në Maqedoni, ndërsa organizohet në kuadër të OKB-së dhe UNESCO-s "Për dialog mes civilizimeve" dhe "Për kulturën e paqes". Në tubim marrin pjesë mbi 300 përfaqësues, ku 200 janë përfaqësues nga grupet religjioze dhe nga bashkësitë fetare. Janë ftuar përfaqësues të Kishës Ortodokse Maqedonase, nga Bashkësia Fetare Islame, nga Kisha Katolike, Bashkësia Hebraike

dhe Kisha Evangjeliste-Metodike në Maqedoni, nga përfaqësitë konsullorë-diplomatike të Maqedonisë në botë, të religjioneve nga të gjitha kontinentet, nga fondacionet ndërkombëtare si dhe delegacione nga Vatikani. Organizator i konferencës është Ministria e Kulturës në bashkëpunim me Komisionin për marrëdhënie me komunitetet fetare e grupet religjioze dhe me bashkësitë fetare. Konferenca financiarisht është e ndihmuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, nga UNESCO, si dhe nga Konferenca botërore për religjione e paqe.

Në këtë Konferencë morën pjesë disa prelatë shqiptarë: Mons Zef Gashi, Arqipeshkëvi i Tivarit; Mons Angelo Mas-safra, Arqipeshkëvi i Metropolit i Shkodrës; Mons Dodë Gjergji, Ipeshkëvi i Kosovës; Mons Lucjan Avgustini, Ipeshkëvi i Sapës. (A.J.)



Ohri

Udhëtim i Krishtlindjes

Kapitulli i parë dhe i dyti i Ungjillit sipas Mateut dhe Lukës, quhen ungjilli i foshnjërisë së Jezusit. Porosia këtyre kapitujve është kjo: Hyji hyri në historinë e njerëzimit, Hyji zuri vend në mesin e njerëzve, me qëllim që njerëzit, njerëzimi të gjejë lumturinë. Vetëm në këtë prizëm mund të kapim kuptimin e plotë ungjillor. Ngjarjet që i gjejmë në këta kapituj, rrjedhin në sekuenca të shpejta dhe në skenë dalin

shumë personazhe. Mirëpo, protagonistit është Ai, Jezusi nga Nazareti, biri i Davidit, biri i Marisë, Biri i Hyjit. E përmenda daljen në skenë të shumë personazheve. Kësaj here nuk do të flas për ta, por për lëvizjen, ecjen, për mosecjen e tyre! Shumica janë në udhëtim, në ecje, por jo të gjithë; ndoshta ecin në të njëjtën rrugë, por arrijnë në vende e qëllime të ndryshme.

■ SHKRUAN:
Luz PANUKO

Disa bëjnë që tjerët të ecin
Shën Luka shkruan: "Në atë kohë Cezari August dhe urdhëroi të bëjë regjistrimi i popullsisë së mbarë botës. Ky ishte regjistrimi i parë, kur Kuirini ishte qeveritari i Strisë. Të gjithë shkonin të regjistroheshin, secili në qytetin e vet. Kështu edhe Jozefi, pasi ishte prej shtëpisë dhe prej fisit të Davidit, u ngjiti, prej qytetit të Nazaretit të Galileesë, në Jude, në qytetin e Davidit që quhet Betlehem, për t'u regjistruar bashkë me Marinë, fatin e vet, që ishte shtatzënë".

Këta dy, Augusti e Kuirini, vunë në udhëtim shumë njerëz, edhe pse mbi Jozefin, Marinë shtatzënë dhe Jezusin nuk dinin asgjë. Me mija udhëtarë! Edhe Jozefi me fatin e vet, mori rrugën në qytetit të Davidit, pasardhësit të tij.

Disa të tjerë nuk udhëtojnë fare: mbesin indiferentë

Shën Mateu thotë: "Pasi Jezusi leu në Betlehemin e Judesë, në kohën e mbretit Herod, kur që, prej Lindjes ia behën në Jerusalemin disa Dijetarë. (...) Mbreti Herod... i bashkoi të gjithë kryepriëstëritë e shkriftit e popullit dhe i pyeti ku duhet të lindë Mesia. Ata i përgjigjën: 'Në Betlehemin e Judesë'". Bashkëbiseduesit e Herodit i konsultojnë librat, hulumtojnë profecitë dhe gjejnë përgjigjen "Në Betlehemin e Judesë". Të gjithë këta bashkëpunëtorë të Herodit ndalen në Jerusalemin, secili në punën e vet. Asnjëri prej tyre nuk e merr rrugën për Betlehem. Mund të thuhet se mbesin indiferentë për këtë ngjarje. Indiferentizmi është ushqim, nxitje e udhëtimit kah zbatimi i urrejtjes, përpjekjes, e, së fundi, edhe vdekjes së të afërmit. Vrasja mund të bëhet në mënyra të ndryshme. Mjerisht, jemi aq mirë të njoftuar me mënyrat e vdekjeve, saqë duket se është bërë, pranohet si një gjë e rëndomtë. E nuk duhet të jetë kështu, sepse nuk ka nevojë për vrasje, vdekja vjen vetë në kohën e caktuar. Këta këshilltarë e dijetarë mbretërorë nuk ecin për ta takuar Mesinë, Shpëtimtarin e njerëzimit, por me lojalitetin

e tyre çnjerëzor përgatisin planin për ta vrarë Atë. Ndodh një masakrim i paparë në atë kohë. Masakrimi justifikohet, kinse me mbrojtjen e fronit apo për ta shuar komplotin e përgatitur kundër Herodit. Edhe sot e hasim një lojalitet të këtyllë, një indiferentizëm moral e fetar. Sa aborte bëhen gjatë vitit, gjatë festave të Krishtlindjes në botën e qytetëruar? Sa fëmijë vriten nëpër rrugët e metropoleve të mëdha fshehtas? Sa fëmijë tretren, kidnapohen, vriten për shitjen e organeve të trupit? Sa eksperimente farmaceutike bëhen në fëmijë me handikapë, të internuar nëpër institute e

jetarët, u zemërua së tepërmi dhe urdhëroi të vriten të gjithë fëmijët meshkuj që ishin në Betlehem dhe në mbarë vretbinën e tij dy vjeç e poshtë – simbas kohës që me kujdes e betoi nga Dijetarët".

Sa e tmerrshme duket kur Krishtlindja për dike është festë vuajtje, përndjekje, vrasje. Ndër shumë shkaqe, dy janë më evidente: indiferentizmi (të qëndruarit në një vend) dhe vrasja (udhëtim vdekjeprurës). Mbi të parin dhe natyrën e tij, folëm më sipër.

Sot, në Perëndim, është krijuar një atmosferë që nuk është thellësisht e krishterë dhe kishtarë. Kjo në shumë vende

u tha: 'Mos kini frikë! Ja, unë po ju sjell një lajm të mirë: gëzim të madh për mbarë popullin! Sot, në qytet të Davidit ju lindi Shëlbuesi – Krishti Zot! Dhe, ja shenja për ta njohur: do të gjeni një foshnjë të mbështjellë me shpërgënjë e të vënë në grazhd'. (...) Posa engjëjt u larguan prej tyre në qiell, barinjët i thanë njëri – tjetrit: 'Ejani të shkojmë, pra, deri në Betlehem e të shohim çka ndodhi – ngjarjen që na e kumtoi Zoti'. Shkuan me nxitim dhe gjetën Marinë, Jozefin e Foshnjën të vënë në grazhd. Kur e panë, u treguan ç'u tha engjëlli për Foshnjën. Të gjithë ata që i dëgjuan, u mrekulluan nga ato që thanë barinjët. (...) Barinjët mandej u kthyen duke lëvduar e madhëruar Hyjin për gjithçka kishin dëgjuar e parë, pikërisht ashtu siç u tha engjëlli".

Barinjët tregohen të gatshëm, të hapur ndaj kumtimit të Zotit dhe marrin rrugën, ecin për ta njoftuar, për ta adhuruar Fëmijën e lindur. Të padijshëm, jo intelektual, të thjeshtë, krejt natyrisht, anëtar të popullit të zgjedhur. Barinjët kthehen të gëzuar në zemër e këngë lavdi në gojë. Në fillim të trembur, pastaj të gëzuar, duke mos bërë shumë pyetje ekzistencialiste apo abstrakte. Ndërkohë kuptuan porosinë. I dëgjshëm është ai që kupton efektin, thotë një fjalë e urtë.

Në këtë pjesë ungjillore takojmë edhe një kategori tjetër të udhëtarëve. Edhe mbi këta na shkruan Shën Mateu: "Kur që, prej Lindjes ia behën në Jerusalemin disa Dijetarë, e pyeten: 'Ku është foshnja e lindur, që do të bëhet mbreti i judenjve. Sepse e pamë yllin e tij duke lindur dhe erdhëm t'i shprehim nderimet tonë'. Një herë të njoftuar me vendin e lindjes së Mbretit. Vazhdonmë të lexojmë: "Ata, si e dëgjuan mbretin, u nisën. Dhe ja, ylli që kishin parë në lindjen e tij, u shkollte përpara derisa zuri vend aty ku ishte fëmija. Ata, kur e panë yllin, u bënë shend e verë. E, si bynë në shtëpi, panë fëmijën me Marinë, fëmijën e tij, ranë përmbys dhe i shprehën nderimet e tyre. Pastaj hapën thesaret e veta e i

dhuruan: ar, kem e mirrë".

Është fjala për njerëz që vinin nga vende të largëta, jo anëtarë të popullit të zgjedhur, që vihen në udhëtim, megjithëse duheshin bërë rrugë të gjatë. Njerëz të dijshtëm, intelektualë, të mençur, të njohur. Njerëz këta që kanë shumë pyetje, dyshime, shqetësime. Këta udhëtojnë, nuk mbeten indiferentë, kërkojnë, informohen, dëshirojnë dhe presin përgjigje: kanë për qëllim të takojnë Zotërinë. Në Ungjill nuk lexojmë se u kthyen të gëzuar, por pasi që e panë, takuan, adhuruan Mbretin, kthimi i tyre, si mund të jetë ndryshe, pos i gëzuar!

Si barinjët e thjeshtë, edhe këta dijetarë ecën në takim, në drejtim të Foshnjës, panë Foshnjën, e adhuruan Foshnjën dhe u kthyen në jetë të tyre me Foshnjën. Asnjëri prej tyre nuk u ndal në Betlehem. Gjatë udhëtimit kah Betlehemi ishte në kthimin e tyre, fuqia hyjnore dhe ato që i udhëzonte dhe i përcillte.

Këtu na bie në mend edhe për një mori të të krishterëve që janë në ecje drejt Foshnjës: në shërbim të të vobektëve, të të vuajturve, të harruarve nga shoqëria e nga gjiri familjar, të vetmuarve, në spitale, në shtëpia të pleqve, në foshnjore, në katastrofë; nëpër rrugë e sheshë...; në botë, e larg botës, duke parë Foshnjën në secilin njeri. Shumë të krishterë, mjekë, asociaçione, lëvizje kishtarë, dedikojnë pushimet dimërore për të ndihmuar shumë shtete të pazhvilluara për rritjen e tyre kulturore, për zhdukjen e analfabetizimit etj. etj. Ndër ta ka edhe anëtarë të Kishës sonë (ndër shqiptarë), që në mundësitë dhe kontributin e tyre modest, duke mos u larguar larg kufijve, e shpërndajnë në rrethin e tyre të ngushtë të njëjtën rreze të dashurisë së Hyjit.

Ky është kuptimi i vërtetë i Krishtlindjes: ecja për të takuar Foshnjën që lind. Ndoshta takimi do të bëhet pa dhurata, me të gjitha brishtësitë, dobësitë, mëkatet. Me asgjë tjetër, pos vetvetes. Me bukurinë e qenies, me lumturinë e jetës së krishterë.

“Ky është kuptimi i vërtetë i Krishtlindjes: ecja për të takuar Foshnjën që lind. Ndoshta takimi do të bëhet pa dhurata, me të gjitha brishtësitë, dobësitë, mëkatet. Me asgjë tjetër, pos vetvetes. Me bukurinë e qenies, me lumturinë e jetës së krishterë.”

orfanotrofi, nëpër spitale psikiatrike? Sa fëmijë janë viktimë të kënaqësisë egoiste të të moshuarve, pasanikëve, pedofilëve. Sa Heroda ka në këtë botë, kur njeriu konsiderohet vetëm si konkurrent, pengesë, mjet, kur ai nuk prodhon, duhet t'eliminuar'. Ai nuk konsiderohet krijesë e Hyjit, për të cilin erdhi Jezusi, mori hapin e parë për t'u takuar me të.

Një numër i vogël i gëzon të gjitha pasuritë e kësaj toke, që është e të gjithëve, derisa shumica vdesin nga uria, nga sëmundje të ndryshme, nga mungesa e ujit. Janë të pakuptueshëm konsumimi i barnave, hedhja e bukës e ushqimeve tjera, përdorimi i pakontrolluar i ujit etj., në vendet e zhvilluara, kurse në vendet e varfra vdesin njerëz në mungesën e tyre.

Disa të tjerë udhëtojnë, marrin rrugën vdekjeprurëse

Po aty shën Mateu thotë: "Mbreti Herod, posa i dëgjoi këto fjalë, u shqetësua". Disa rreshta më vonë, ungjilltari vazhdon: "Atëherë Herodi, kur pa se e mashtruan Di-

tashmë duket sheshit. Aty e Vërteta prodhon frikë, vlerat morale shtypen në emër të lirisë së shfrenuar dhe kamjes ekonomike. Është një botë, të cilën më shumë se gjysma e popullatës botërore mendon se është e krishterë. Shpeshherë ndodh që të krishterët e pafaj vuajnë, përndiqen padrejtësisht, për arsye që janë nga Perëndimi i krishterë, apo identifikohen me fenë e Perëndimit. Kësi të krishterësh nuk ka shumë. Të krishterët e vërtetë në Perëndim e përjetojnë një martirizim të veçantë, të nënçmimit dhe përqeshjes, përjashtimit dhe trysnisë psikike me qëllim të përshatjes mentalitetit antikishtar.

Disa të tjerë udhëtojnë, marrin rrugën jetëdhënëse: takimi me Foshnjën

Rreth lindjes së Jezusit takojmë edhe ata që, kur dinë, nuk frikohen, sikurse shkruan Shën Luka për barinj: "Në atë vend ishin disa barinj, të cilët e kalonin natën përjashta për të ruajtur grigjën e vet. Engjëlli i Zotit u afrua tek ata dhe lavdja e Zotit i shndriti e ata u trembën për së tepërmi. Engjëlli

Etërit e Kishës

Shën Injaci i Antiokisë († 107)

■ SHKRUAN:
Don Marjan DEMAJ

Shën Injaci i Antiokisë ka shjetuar në fund të shekullit të parë dhe në fillimin e shekullit të dytë – mu në kohën kur jetoi edhe shën Klementi. Ishte kohë kur të gjithë apostujt kishin vdekur. Kishën tani e udhëheqin ata, të cilët personalisht as nuk e kanë dëgjuar dhe nuk e kanë njohur Zotërinë. Detyra primare për këta udhëheqës ishte lidhja e fortë e bashkësive kishitare.

Antiokia pas Jerusalemit ishte vendi i dytë i krishterë, ndërsa për kah madhësia ishte vendi i tretë në perandori. Një qytet, i cili quhej *qyteti i dritës* dhe ishte krenaria e asaj kohe, sot është nën gërmadha.

Nga Antiokia shën Pali nisët për rrugët e veta misionare. Po ashtu libri i Zbulesës së Gjonit apostullit, i shkruar në fund të shekullit të parë, përmend se në këtë rrethinë ishin shtatë kisha, shtatë ipeshkvi, të vendosura në anën perëndimore të Antiokisë. Pas rrënimit të Jerusalemit Antiokia ishte kështjellë e fesë. Këtu nxënësit e Jezu Krishtit për të parën herë u quajtën të krishterë. Ky vend ishte i pari vend i Selisë së shenjtë, në krye me shën Pjetrin. Injaci ishte ipeshkëv në fillim të shekullit të dytë në Antioki.

Për rininë e tij nuk dihet asgjë. Ne sot për shën Injacin dimë vetëm kur ishte i burgosur e deri në martirizimin e tij. Ishte nga një familje pagane me kulturë greke. Kjo është e gjithë ajo që dihet për të kaluarën e tij. Injaci u burgos gjatë kohës kur perandori ishte Trajani. Njerëzit në këtë kohë përjetonin mundime të vërteta të mëdha, jetonin në kushte shumë të vështira. Bashkësisë së krishterë i nevojiteshin njerëz të fuqishëm shpirtërisht, të cilët me dinjitet dhe shembull do ta udhëhiqnin popullin. Njerëz të cilët as burgu, as shpata, as mundimet e shumta nuk do t'i ndanin nga dashuria ndaj Zotit dhe vëllait njeri. Injaci ishte një fatos ndër të parët që

nuk i trembej syri. Ky njeri kishte një dëshirë të madhe, kishte një dashuri të vërtetë, të martirizohet që të bashkohet sa më shpejt me Krishtin. Injaci dëshiron të vdesë për Krishtin! Dhe ja, dëshmoret se ka shpirtin, ka njerëz të cilët e kthejnë dashurinë me dashuri, të fllojnë jetën për Jetë.

Nga jeta e tij në burg veçohet trimëria e fesë dhe durimi në vuajtje për t'u bashkangjitur në vdekjen dhe ringjalljen e Zotërisë. Injaci i përjetoi të gjitha nënçmimet e romakëve. Ai u dërgua në Romë për një lojë satanike me egërsira që dinin t'i bënin vetëm të patenzonët për zbatimet e tyre. Rrugës për Romë ata u ndalën në Smirnë. Polikarpi nxënës i dashur i shën Gjonit ungjilltar, i doli në takim bashkë me besimtarët për ta pritur. Këta i shprehën nderim dhe solidaritet. Takimi me këtë njeri të shenjtë i trimëronte të tjerët, që shihnin se si ai e bart kryeqin me duresë dhe dashuri. Ndërsa për Injacin ishte kjo një fuqi shpirtërore se vëllezërit e tij nuk e kishin haruar as në vuajtje. Më vonë Injaci, edhe pse i burgosur, do t'u shkruajë letra falënderimi të gjithëve. Nga burgu dërgon edhe Letrën e njohur drejtuar Romakëve. Kjo Letër është e njohur, sepse ai i lut vëllezërit që mos të ndërmarrin asgjë për ta lëruar. Sepse dëshiron të vdesë për Krishtin, i cili më parë vdiq për të. Nga Smirna shkoi në Troadë, asaj rruge kah kishte shkruar dikur edhe shën Pali. Yjet e krishterë shkojnë njeri pas tjetrit për Romë, qendrën e atëhershme botërore dhe pagane, ku për fat të keq shumë prej tyre shuhën për momentin, por që megjithatë shndrisin duke e bërë Romën qendër krishterimi.

Karakteri i Injacidit i zbuluar nga letrat e tij

Injacin e zbulojnë letrat e tij. Të gjitha së bashku janë shtatë. Në këto letra hetohet origjinaliteti i tij. Këto letra pasqyrojnë shpirtin e tij të mirë. Vetë emri i tij Injaci do të thotë *i zjarrtë*. Injaci pra digjej për Krishtin. Ai në letra shihet se është dinamik, i bind-

shëm dhe i thjeshtë. Nga këto letra del fuqia e mrekullueshme, dashuria e pamasë, mirësi e pakrahueshme, bukuria që përfshin tërë qenien e tij për Zotin dhe për amshimin.

Një shembull konkret nga Letra dërguar Polikarpit: *Nuk është vështirësia në atë që të gjithë njerëzit t'i duam, por të duam çdo njeri, posaçërisht të vegjlit, të sëmurët, robërit... dhe ata që na fyjnë dhe mundojnë. Njerëzit duhet t'i përmirësosh në atë mënyrë që mos t'ua ktheshe me fyerje me atë masë që të bëjnë. Ignaci pastaj pyet: Si mund të arrihet kjo? Me duresë dhe qëndrueshmëri. Nuk nevojitet shumë për t'u zgjidhur problemi. Injaci flet nga përvoja, flet nga jeta e sprovuar në kryeqe dhe vuajtje. Për nga natyra ishte njeri i fortë, por duresa e bëri të butë, përvujtëria e lartësoi. Në sharje dhe fyerje ai i bekonte, në dhunë përgjigjej me thjeshtësi, ndërsa ndaj herezive me fe të fortë. Kjo ishte dhe mbeti recetë për të gjitha kohërat. Injaci ishte ipeshkëv, ishte përgjegjës për shumëçka. Në raste të shumta thoshte se jam në rrezik, sepse pushteti dhe lavdia njeriun e debitojnë sikurse vera. Disa mjerisht mbyten edhe në një pikë të saj, por të mëdhenjtë nuk trazohen, edhe sikur të shkonte sikurse lumi. Pse? – pyet Injaci. Sepse këtë e kuptojnë si rrezik dhe jo si gazmend të jetës. Motivimi dhe forca që e ngriti Injacin në këtë nivel, është jeta e amshuar, e cila nuk bazohet në gjëra që një ditë kalojnë dhe shuhën, por në ato që kurrë nuk kalojnë dhe janë të përjetshme. Garanci për motivimin e fortë të Injacidit ishte personi i Jezu Krishtit. Ai me këtë rast thoshte: *Nu ka tjetër mjek në këtë botë, përveç Zotit, i cili u mishërua nëpërmes Marisë Virgjëre, Jezu Krishti Zoti ynë... E dua Jezusin, i cili vdiq për ne, Jezusin, i cili u ngjall për ne dhe në atë moment kur unë do ta përjetoj këtë do të filloj të jetoj. Injaci mendonte se vetëm në Zotin është gëzimi, lumtëria dhe harmonia shpirtërore. Ai si bari i mirë mësonte atë që edhe vetë e jetonte që njerëzit të mos lëkundën në fe, paganizmi të mos**

i dëmtojë dhe të jenë të qëndrueshëm.

Vdekja

Koloseumi i Romës për romakët ishte vend i zbatimës, i argëtimit. Në të gladiatorët në dyluftim mes veti, shpesh edhe me egërsira, luftonin për lirinë e vet. Pra derisa derdhej gjaku i njerëzve të pafajshëm, romakët dëfroheshin dhe gëzoheshin. Me kohë në Koloseum filluan t'i sjellin edhe të krishterët, duke i hedhur para egërsirave të uritura dhe të tërbuara! Kështu, një ditë në këtë Koloseum u ndeshën edhe bari i mirë dhe i urtë Injaci dhe egërsirat e uritura që i kishin përgatitur për këtë rast. Për romakët ishte kjo një fitore, po zhdoknin edhe një njeri të madh, ndërsa për të krishterët ishte një humbje e madhe – vdekja martire e Injacidit. Por dëshira e Injacidit ishte që ta lejonin të bëhej ushqim i egërsirave, për t'u bashkuar me Zotërinë. Sot kur shikojmë Koloseumin, mund të pohojmë se ai është turpi pagan, në të cilin mbi 200 vjet egërsirat i copëtonin njerëzit që predikonin dashurinë, paqen, mirësinë dhe Zotin, i cili u mishërua dhe jetoi në mesin tonë për të na bërë pjesëtarë të amshimit të vet.

Ne për Injacin nuk dimë

shumë, por besoj se edhe kjo është e njaftueshme për ta treguar burrërinë, trimërinë dhe fenë e tij të fortë dhe të palëkundshme në Zotin, të cilit ia flloji jetën për t'u bërë dritë të tjerëve. Përkujtimin e martirizimit të tij Kisha e feston më 17 tetor.

Veprat

Injaci shkroi shtatë letra të dërguara kishave në Azinë e Vogël, Efez dhe Magnezi. Letrat duken të thjeshta, por porosia e tyre është e madhe. Ai kërkoi nga besimtarët të ruhen nga herezitë dhe ndarjet e ndryshme. Stili i letrave është shumë i gjallë. Këto letra janë lexuar dhe respektuar shumë në Kishën e parë. Më e bukura ndër to është ajo e drejtuar romakëve, në të cilën shën Injaci shkruan: *Fruentum sum Dei et per ferarum dentes malor, et purus panis Christi inveniar – Unë jam gruri i Krishtit dhe duhet të jem i bluar prej dhembëve të egërsirave, që të bëhem bukë e pastër e Krishtit* (IV, 1).

Mund të hetohen se Letrat janë të shkruara shpejt, ashtu sikurse mund të shkruajë një i burgosur para rojtarëve, të cilët e mundojnë në çdo mënyrë: *„i lidhur në mes dhjetë rojtarëve të cilët më ruajnë sikurse leopardë përthet* (V, 1).

Fragment nga letra drejtuar romakëve

Ignaci i quajtur edhe Teofor [= Hyjmbartës], Kishës... me nder dhe lavdi dhe sukses... gjithmonë plot hir të Zotit, larg nga çdo njollë, dëshiron gëzimin më të pastërtin në Jezu Krishtin, Zotin tonë.

Pas lutjeve të shumta kam kërkuar hir që të mund t'i shikoj fytyrat tuaja. Hiri m'u dha edhe më shumë se sa u luta, që kam mundësi edhe personalisht t'u përshëndes, unë i burgosur për Jezu Krishtin, në qoftë se mirësia e Zotit më bën të denjë të më plotësohet dëshira. Fillimi është i mirë... por frikësohem që dashuria juaj ndaj meje do të më bëjë dëm. Ju mund të bëni atë që doni që të më llojnë, por edhe nëse e arrini qëllimin, mua m'i ndërroni planet për të arritur tek Zoti. Pra, ju lutem, mos më dëmtoni. Dua të shkoj tek Zoti! Nuk dua të kërkoj atë çka i pëlqen njeriut, të cilin ju i jeni besnikë. Unë nuk kam më rast të tillë sikurse tani të arrij tek Zoti. Prandaj nëse ju nuk ndërmerrni asgjë për mua që të më llojnë, do të bëni një vepër të madhe. Në qoftë se ankoheni, unë nuk do të jem asgjë, vetëm se zbrazëti. Më lejoni, pra, vetëm këtë, të jem i flijuar për Zotin, pasi që është përgatitur altari, sepse është mirë që të vdesësh për botën e të jetosh për Zotin. Ju përbej të mos ankoheni për mua. Dëshiroj të jem ushqim i egërsirave, sepse vetëm kështu do të arrij tek Zoti. Unë jam gruri i Krishtit dhe duhet të jem i bluar prej dhembëve të egërsirave, që të bëhem bukë e pastër e Krishtit. Ledhatoni ato egërsira që do të më bluanë, sepse ato janë varri im. Kisha dashur që të mos mbetet asgjë nga unë, që të mos jem barrë e askujt. Lutuni për mua që të jem fli e pëlqyeshme e Hyjtit... E kërkoj atë që vdiq për mua, e dua atë, i cili u ngjall për mua... Dhe në qoftë se martirizohem, do të jetë shenjë se më keni dashur, e, në të kundërtën, këtë do ta shoh si urrejtje ndaj meje... Në lutjet tuaja kujtojeni Kishën në Siri... Këtë letër po ua shkruaj nga Smirna dhe ua dërgoj nëpërmes efesianëve të dashur... Dita është 9 gusht, lamtumirë.

Jini të fortë deri në fund në mundime për Jezu Krishtin.



Antiochia sot

Familja ndërmjet personit dhe shoqërisë (I)

Si qelizë e shoqërisë, si bashkësi e personave (burrë-grua-fëmijë), prej familjes bashkëkohore kërkohet roli ndërmjetësues që duhet të luajë ajo sot, në periudhën e quajtur (post)moderne. Funkzioni i saj gjithmonë është të qëndrojë midis të shkuarës dhe të ardhmes, midis individit dhe shoqërisë, duke ndërmjetësuar vlerat në balancimin e tendencave apo drejtimeve individualiste dhe atyre kolektiviste, varësisë dhe pavarësisë. Si organ natyror në këtë pozitë familja shfaqet me fytyrën e saj private dhe atë publike. Shikuar në këtë këndvështrim nuk është për t'u çuditur përse prej familjes pritet aq shumë dhe përse pikërisht prej saj mund të dalin edhe zhgënjimet më të mëdha. Vetë funksioni ndërmjetësues i familjes, si institucion "elementar", në mes individit dhe shoqërisë e bën atë një vend tensionimi që përjetohet apo shkakton "krizë" (= rast për vajtim apo mundësi të reja).

■ SHKRUAN: P. Shtjefën DODES J

Bashkë me shoqëri të ndryshme qytetëruese, edhe shoqëria bashkëkohore shqiptare (kosovare), sidomos prej vitit 1990 e këtej, po ballafaqohet me realitetin e tranzicionit apo (sh)ndërrimit, pasojat e të cilit mund t'i shohim dhe (po) të përjetojmë sidomos në familje. Në të vërtetë, përpjekjet dhe interesimi për ta kuptuar rolin e saj, kanë qenë

Me rëndësi është se çfarë kuptimi i japim asaj dhe si (po) luhet roli i saj (i ri).

Ndryshimi i konceptit familjar: Personi – familja – shoqëria

Familja e shteteve perëndimore (moderne, evropiane) bashkëkohore, rrjedhojë kjo e industrializimit, e quajtur edhe qytetare (kryesisht familja bërthamë), me vetëdije apo pavetëdije, është bërë model dhe po imitohet nga

të formuar një hapësirë të jetës private në jetën e përditshme.

Për sa i përket shoqërisë – paralelisht me zhvillimet familjare – rol të madh në ndryshimin e konceptit familjar luajtën organizatat, themelimit e organeve publike: përkujdesi për fëmijë nëpër çerdhe e kopshte, parashkollimi, ndërtimi i shkollave, hapja e këshillimoreve për prindër, sigurimi shëndetësor, ngritja e shtëpive të pleqve, ndihmat sociale etj.

kushtuar më shumë vëmendje çështjes së familjes. Ndryshimet, në veçanti kur flitet për rolet prind-prind, prind-fëmijë dhe fëmijë-prind, por edhe familje-shoqëri; po përjetohen si problematike. Ndjehet një paqartësi dhe nevojë orientimi. Jehonë të madhe bëjnë rastet ku theksohet shturja morale e një individit apo grupi që paraqitet si kërcënim për shoqërinë në përgjithësi. Kjo ngjall pasiguri dhe brengosje të madhe, diku-diku edhe një lloj paniku të fshehur të prindërve për ardhmërinë e fëmijëve të tyre. Në këtë udhëkryq ku ndeshen brezni të tëra, e kaluara me të tashmen, "i ndëshkuar në liri" për të vendosur për fatin tënd, gjenden si prindërit, po ashtu edhe fëmijët e tyre. E gjithë kjo reflektohet pastaj në jetën e të afërmeve të tyre, respektivisht në shoqërinë në të cilën familja jeton.

Në një gjendje të tillë, ku rezultatet e paramenduara dhe të dëshiruara nuk shihen dhe nuk preken, shumë veta që kanë prirjen të marrin qëndrime jo optimiste, madje ardhmërinë e tyre ta shohin vetëm zi. Konkretisht gjendja mbizotëruese, veçanërisht e familjes (kosovare) shqiptare, shprehet më pak me cilësorët pozitivë dhe më shumë me ata negativë si: "e vështirë, e papritshme, e çuditshme, zhgënjyese, e padrejtë, e padurueshme, e pazgjidshme, tragjike..." Gjenden tonë familjare mund ta përshkruajmë si krizë familjare - shoqërore.

Para së gjithash, duhet thënë se kriza si e tillë nuk është medocmos një shenjë që ndjell vetëm zi. Pikërisht kriza e vlerave, ku bën pjesë edhe familja, është ajo që mund të na tërheqë vërejtjen që t'u kushtojmë atyre vëmendje më të madhe. Ajo na shtyn të zgjohemi, të jemi më vigjilentë dhe t'i përdorim të gjitha aftësitë tona për t'u angazhuar në favor të kësaj vlerë. Krizën e vlerave pra duhet parë edhe si rast për ballafaqim, rishikim, pastrim dhe (ri) afirmim të tyre.

Modernizimi shoqëror në prapavijë

Si qelizë e shoqërisë, si bashkësi e personave (burrë-grua-fëmijë), prej familjes bashkëkohore kërkohet roli ndërmjetësues që duhet të luajë ajo sot, në periudhën e quajtur (post)moderne. Funkzioni i saj gjithmonë është të qëndrojë midis të shkuarës dhe të ardhmes, midis individit dhe shoqërisë, duke ndërm-

jetësuar vlerat në balancimin e tendencave apo drejtimeve individualiste dhe atyre kolektiviste, varësisë dhe pavarësisë. Si organ natyror në këtë pozitë familja shfaqet me fytyrën e saj private dhe atë publike. Shikuar në këtë këndvështrim nuk është për t'u çuditur përse prej familjes pritet aq shumë dhe përse pikërisht prej saj mund të dalin edhe zhgënjimet më të mëdha. Vetë funksioni ndërmjetësues i familjes, si institucion "elementar", në mes individit dhe shoqërisë e bën atë një vend tensionimi që përjetohet apo shkakton "krizë" (= rast për vajtim apo mundësi të reja).

Nuk janë të pakta rastet nga jeta e përditshme familjare shqiptare, të cilat po përjetohen si problematike apo tensionuese. Zhvillimet shoqërore e prekin çdonjërin prej nesh krejt personalisht. Për vetë faktin, p.sh. që në Kosovë, me ngjarjet tronditëse, transformuese politike, ekonomike dhe shoqërore në të kaluarën, që i kanë ndryshuar dhe po i ndryshojnë shumë format e jetës dhe modelit e saj, ndërliqet me ne personalisht në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte. Secili prej nesh njih rastet të ndryshme (sh)ndërrimi në familje apo ndër të afërme duke filluar prej komunikimit ndërmjet anëtarëve të familjes, nëpërmjet planifikimeve dhe vendimeve familjare që merren brenda familjes, e deri të mënyra e jetesës me të afërmit dhe të huajt jashtë saj.

Fakti i statusit politik të pagzjidhur të vendit, veprimi i shtetit ligjor, funksionimi i sistemit të drejtësisë, aprovimi i ligjeve për pensione, për siguri shëndetësore, punësim, arsimim, formim, pastaj dukuritë siç janë: ndryshimet në profesion, ndryshimi i rolit të femrës, zbritja e numrit të të lindurve, e anëtarëve në një familje, rritja e numrit të të shkurorëzuarve, një nevojë më e madhe për përkujdesjen e anëtarëve të moshuar të familjes, ndjenja për një raport më të ngushtë, më intim, më të ngritur familjar, - po shfaqen gjithnjë e më shumë. Natyrisht, që të gjitha këto i shtynjë shumë të rinj dhe të rritur të mendojnë dhe të brengosen për sigurimin e jetës së tyre dhe të fëmijëve të tyre. Kërkimet shkencore po-hojnë se zhvillimet ekonomike, sociale dhe kulturore në një shoqëri lidhen ngushtë me zhvillimin e popullsisë, si individit dhe shoqëri.



të pranishme gjatë gjithë historisë. Sidomos në fund të shek. 19 kërkimet sociale-antropologjike mbi fenomenin universal të familjes u bënë më intensive. Thjeshtëzimet e kërkimeve të këtyre shkencëtarëve vazhduan të theksohen për një kohë të gjatë: Familja e madhe apo e zgjeruar e së kaluarës, që përbënte një grup prej tre ose me shumë brezash që jetonin së bashku apo afër njëri-tjetrit (e bazuar në marrëdhëniet prindër-fëmijë-të afërm), si një bashkësi fisnore e gjerë, i ka humbur "funksionet" (rolet) e saj dhe është bërë sot familje bërthamë, që bazohet në marrëdhëniet burrë-grua-fëmijë. Mirëpo, kërkimet e sotshme tregojnë se forma të ndryshme të jetës së përbashkët familjare dhe rregullativa të ndryshme institucionale kanë ekzistuar qëkur. Sot në shoqërinë shqiptare konsiderohet se është ndryshuar struktura e familjes shqiptare tradicionale (kanunore, patriarkale) me tre breza (fëmijë, prindër dhe gjysh e gjyshe, me radhë edhe mixhallarë e halla).

familja shqiptare e ditëve tona. Ajo që ka ndikuar në ndryshimin e konceptit të familjes në botën perëndimore, i ka rrënjët qysh në Mesjetë. Këto ndryshime ndërliqeshin me transformimet rrënjësore të rrethanave shoqërore të atëhershme, si: ndryshimi demografik dhe ekonomik, risitë politike, njohja e individualitetit, ngritja e vetëdijes për të drejtat e njeriut, si dhe ndërtimi i shtetit qytetar. Kulminacioni i këtyre ndryshimeve arriti në kohën e zhvillimeve të shoqërive industriale të shek. 18. Sidomos rol të rëndësishëm luajti prurja e ligjit për frekuentimin e shkollës, për arsimimin dhe formimin e të gjithë banorëve.

Për sa i përket familjes, kërkimet shkencore e kanë vërtetuar se format e jetës familjare në lidhje me ekonominë/buxhetin shtëpiak, në të gjitha kohërat kanë qenë të ndryshme. Sot prej prindërve pritet që si përgjegjësi të parë ta kenë përkujdesjen dhe edukimin e fëmijëve. Familjes i jepet një autonomi e caktuar për

Bota e punës dhe punësimi ka ndikuar po ashtu në qasjen e prindërve dhe detyrave të tyre duke i mbështetur apo penguar ata.

Skenari aktual

Në botën familjare shqiptare shohim, dëgjojmë apo lexojmë, nëpërmjet mjeteve publike të informimit apo vetë i përjetojmë rastet, të cilat na shtynjë për t'i

“ Të gjitha kërkimet shkencore tregojnë detyrën kryesore dhe rolin e dyfishtë të familjes: rolin në lidhje me individin dhe rolin në lidhje me shoqërinë. Për sa i përket individit, familja është vendi i zhvillimit primar të individit si person, të aftësisë së tij për t'u shprehur, të marrëdhënieve të tij me të tjerët. Kurse në lidhje me detyrën shoqërore, familja e luan rolin e saj duke vendosur kufizime, duke bërë rend dhe rregull si dhe duke mbartur vlerat. ”



Katedraja e Shën Patrikut, New York

Vizita e par Imzot Dod në SHBA



Më 28 nëntor 2007 Imzot Dodë Gjergji, i shoqëruar nga Don Franë Kola, famullitar i Velezhës dhe delegat i Administraturës Ap. të Prizrenit dhe Don Lush Gjergji, famullitari i Prizrenit, nisi vizitën e tij të parë baritore besimtarëve shqiptarë në Amerikë.

Gjatë udhëtimit, një ditë para, ai mori pjesë në Bern, në pritjen e organizuar nga Ambasada Shqiptare në krye me Mehmet Elezin, për Ditën e Flamurit dhe 95-vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë, së bashku me përcjellës dhe me meshtarët tanë në Zvicër Don Marjan Marku dhe Don Mikel Sopi si dhe me shumë bashkëatdhetarë.

Të nesërmen, në katedralen e Shën Patrikut në New York, ishte organizuar Lutja Ndërfetare për festën tonë kombëtare. Në këtë takim dhe kremtim të jashtëzakonshëm ndërfetar, morën pjesë kardinali i New Yorkut, hirësia e tij Eduard Egan, Imzot Dodë Gjergji, ipeshkvi ynë, rabini Amiel Wolf, imami i Qendrës

islamike shqiptare Tahir Kukaj, Don Pjetër Popaj, famullitar i Kishës Katolike Shqiptare në New York "Zoja e Shkodrës", shumë besimtarë shqiptarë dhe amerikanë, njerëz të njeteve pamore-dëgjimore, diplomatë, artistë të profileve të ndryshme.

Fjalën hyrëse e mbajti ish kongresmeni Joseph J. DioGuar-di, president i Lidhjes Qytetare Shqiptaro-Amerikane dhe bashkëshortja e tij. Pastaj e lexoi tekstin biblik rabini Amiel Wolf nga Dal 14, 15-16 dhe falënderoi popullin shqiptar për shembullin dhe solidaritetin e tyre ndaj hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Imami Tahir Kukaj këndoi disa rreshta nga Kurani dhe theksoi se toleranca ndërfetare shqiptare ishte virtyt shekullor që ndërlidhte fenë dhe popullin shqiptar.

Imzot Dodë Gjergji e komentoi leximin i Gjin 4, 7-8.16-21 duke theksuar ndër të tjera se jemi këtu "për ta dëshmuar se e duam Zotin, Krijuesin e jetës

ë baritore e ë Gjergjit

SHKRUAN:
Don Lush GJERGJI

Në sinagogën kryesore të New York-ut



Gjatë lutjes në Katedralen e Shën Patrikut

dhe të paqes, dhe njeriun, paqen dhe lirinë, ashtu siç e deshi edhe Nëna jonë e madhe, Nëna Tereze, sepse jemi shëmbëlltira e harmonisë, tolerancës dhe bashkëjetesës fetare...”

Kardinali Edward Egani-i, me fjalë të zgjedhura dhe përmbytësore foli për historinë e popullit dhe të Kishës Katolike ndër shqiptarë, duke theksuar martirizimin shekullor, por edhe shembullin e mirë të bashkëjetesës fetare dhe ndëretnike dhe dëshminë e fuqishme të vlerave dhe të virtyeteve të krishtera që e linden dhe dhuruan Nënë Terezë. “Qëndresa, durimi, martirizimi, dashuria dhe vëllazëria ndërshqiptare janë për ne shembull dhe frymëzim, tregojnë se ky Popull vërtet meriton jetën, lirinë dhe demokracinë e mirëfilltë” përfundoi ai.

Takimin e mbylli Josef dhe Shirlyan DioGuardi duke falënderuar Kardinalin, Ipeshkvin, Rabinin dhe Imamin për këtë takim urate dhe dëshmi vël-

lazërie ndërfetare.

Tenori shqiptar Kreshnik Zhabjaku këndoi “Lavdi e ndera” të Franz Joseph Haydnit, ndërsa këngëtari amerikan John Des Merai si “For the Healing of the Nations”.

Pas këtij takimi urate, urimi dhe kremtimi vijoi kokteji vëllazëror në lokalet e katedrales së New Yorkut.

Ishte kjo një përvojë tejet e rrallë dhe shumë e rëndësishme për Kishën dhe Popullin tonë, për vëllazërinë gjithëshqiptare, për urime dhe përgëzime për Ditën e Flamurit, për Kosovën tonë, për gjithë shqiptarët në Amerikë dhe kudo në botë.

Më 29 nëntor në “Minskof Cultural Center” u mbajt takimi me kryerabinin Arthur Schneir, me pjesëmarrje të Imzot Dodë Gjergjit me përcjellës, Joseph J. DioGuardi, Dr. Brigita Blaha, Konsule Gjenerale e Austrisë, G. Michael Eisenstadt, drejtorin ndëkombëtar të “Appel of Conscience Foundation” dhe Don Pjetër Popaj, famulltar i Kishës

“Zoja e Shkodrës” në New York. Gjatë bisedës dhe drekës vëllazërore u bisedua për gjendjen e Kosovës, për paqe dhe pajtim ndërjetar dhe ndëretnik, për bashkëpunim dhe bashkëjetesë në paqe dhe në harmoni me të gjithë.

Imzot Dodë Gjergji paraqiti përcaktimet tona dhe përvojën shekullore dhe aktuale ndërjetare, si dhe projektin e ndërtimit të Shënjtërores dhe Katedrales “Nëna Tereze” në Prishtinë, si shenjë, simbol dhe mundësi konkrete për kultivimin e këtyre vlerave universale njerëzore dhe kristiane sipas shembullit të së Lumës Nënë Tereze.

Të shtunën, më 1 dhjetor, Imzot Dodë Gjergji mori pjesë në lutje në Sinagogën hebraike për paqe dhe ua drejtoi disa fjalë përkatëse pjesëmarrësve të këtij takimi ndërjetar.

Më 2 dhjetor Imzot Dodë Gjergji e udhëhoqi meshën në Kishën “Zoja e Shkodrës” në New York, me bashkëmshim të Don Pjetër Popajt, Don Franë Kola dhe Don Lush Gjergji. Në pretkun e rastit, Ipeshkvi ndër të tjera falënderoi të gjithë bashkëkombësit tanë nga gjitha viset shqiptare për kontributin e tyre dhënë Kosovës gjatë viteve të sprovës dhe të vuajtjes, duke i ftuar në besnikëri dhe dashuri të vazhdueshme ndaj Zotit, Kishës

dhe popullit shqiptar, ndaj njëritjetrit.

Pas meshës në Qendrën “Nëna Tereze” ishte takimi dhe kokteji vëllazëror, gjatë të cilit u projektua plani i ndërtimit të Shënjtërores dhe Katedrales “Nëna Tereze” në Prishtinë dhe filloi fushata për grumbullimin e mjeteve financiare për këtë projekt.

Më 3 dhjetor Imzot Dodë Gjergji me përcjellësit e tij dhe me meshtarët Don Pjetër Popaj-n dhe Don Ndue Gjergji-in vizituan Federatën Panshqiptare “VATRA”, ku patën një bisedim dhe takim vëllazëror me kryetarin e saj dhe bashkëpunëtorët e tij, si dhe një darkë të mikpritjes tradicionale shqiptare. Ipeshkvi ynë vlerësoi lart rolin historik të këtij institucioni të rëndësishëm për kulturën shqiptare në trojet amerikane dhe më gjërë.

Pas New Yorkut Imzot Dodë Gjergji vizitoi edhe dy kishat dhe famullitë tona shqiptare në Detroit: “Shën Palin” në Rochester Hills, të cilën vite me radhë e udhëhoqi me kujdes dhe dashuri të madhe Dom Anton KÇIRA, së bashku me motrat françeskanë të “Zojës së Papërlyer” dhe “Zoja Pajtores e Shqiptarëve” në Southfield që e udhëhoqi Dom Ndue GJERGJI.

Bashkësia shqiptare katolike

e “Zojës Pajtores e Shqiptarëve” me 20 dhe 21 teor 2007 kremtoi 30 vjetorin e themelimit të kësaj familje si dhe blerjen dhe bekimin e kishës dhe qendrës së re baritore.

Më 9 dhjetor Imzot Dodë Gjergji së bashku me Dom Anton KÇIRËN kremtoi meshën e shenjtë dhe iu drejtua popullit me fjalë frymëzuese për përgatitjen shpirtërore të festave të Krishtlindjes si dhe për projektin e ndërtimit të Katedrales në Prishtinë.

Më 16 dhjetor Ipeshkvi ynë ia paraqiti Hyjit kremtimin eukaristik së bashku me Dom Ndue Gjergjin. Në pretkun e rastit foli për besnikërinë ndaj Zotit, Kishës dhe Popullit Shqiptarë dhe shpjegoi shkurtimisht arsyet e ndërtimit të katedrales “Nëna Tereze” në Prishtinë.

Gjatë kësaj pasie baritori Imzot Dodë Gjergji u takua edhe me kryesuesin e Teqes “Baba Rexhep” në Detroit si dhe me përgjegjësien e xhamisë së shqiptarëve në të njëjtin qytet.

Besimtarët në krye me meshtarët tanë, por edhe shqiptarët tjerë, veçmas bektashitë, e përkrahen nisjen e ndërtimit të Shënjtërores së Nënë Tereze duke dhënë disa kontribute dhe duke premtuar vazhdimësi në këtë projekt.



Muzika

Na thoni diçka më shumë për librin që e keni botuar tash rishtas?

V. Gjini: Libri është shkruar për nevojat e studentëve të Akademisë së Muzikës, sidomos në Prishtinë, por mbasi i kam pasur recensentët nga Shqipëria, do t'u bjerë në dorë edhe studentëve të Tiranës. Është lëndë profesionale, libri quhet *Harmonia*. E kur më pyesin çka do të thotë harmonia e çka paraqet në muzikë, me fjalë të thjeshta mund ta them se harmonia është matematikë e lartë. Është lëndë, e cila i udhëzon të rinjtë për të kompozuar muzikë. Është shkollë fillestare e kompozimit. Libri është i dedikuar për tri vite të studimit. E kam ndarë në dy vëllime. Për shtypjen e librit na ka ndihmuar Ministria e Kulturës së Kosovës. Është shtypur në tirazh nga një mijë copë. Tani gjendet në shitje në Prishtinë dhe në Tiranë.

Keni një përvojë të madhe në arsim. Ne tani kemi bindjen se po punohet 'shkel e shko', si në art si në të gjitha fushat tjera të shkencës?

V. Gjini: Ka 15 vjet që unë jetoj këtu në Istër, në Bujë. Deri në pension kam punuar në Akademinë e Muzikës. Jam profesor i parë në përgjithësi i kualifikimeve të larta, sepse ne shqiptarët nuk kemi pasur kuadro për muzikë. Unë derisa e kam kryer shkollën e ulët dhe të mesmen në Prizren, nuk e kam pasur asnjë mësimdhënës me titull profesor. Prej shqiptarëve unë jam i pari, i cili kam kryer, në realitet, dy fakultete dhe magjistraturë. Fakultetin dhe magjistraturën i kam kryer në Beograd për harmoni dhe kontrapunkt, kurse

kompozimin e kam kryer në Shkup si student i rregullt. Pastaj kam punuar në Prishtinë dhe jam krijuar në katedrën së muzikës në Prishtinë në vitin 1963, mandej e shndërruar ngadalë në Akademi të Muzikës. Kemi krijuar mjaft kuadro aty, si shqiptarë si të kombësive të tjera.

Tash shpejt jam takuar me disa kolegë nga Prishtina, kishin një koncert në Pula, ishte kori i Radiotelevizionit të Kosovës, dhe gjatë bisedës më kolegët aty, më janë ankuar për sa i përket kualitetit të kuadrove, por shpresoj në të ardhëm do të aftësohen më shumë e do të kontribuojnë më shumë.

Na thoni diçka për gjeneratën e artë të dikurshme, Lorenc Antoni, familja Kaçinari, ju, pastaj Dhomi etj...?

V. Gjini: Lorenc Antoni ka qenë mësuesi ynë i parë, atë e kam pasur drejtor në shkollën e ulët dhe të mesme në Prizren. Ai ka qenë kompozitori ynë i pari, i cili ka dhënë mjaft për sa i përket muzikës dhe ka krijuar. Pas tij ne jemi shtatë tetë persona që patëm kryer shkollën në Beograd. Mark Kaçinari ka qenë kolegu im, i cili ka krijuar sa i përket muzikës korale për shoqatën Colegium Cantorum, në të cilën edhe unë isha si ndihmës i tij për njëzet vjet në korin që ai e udhëhoqte. Programi ishte mjaft interesant dhe kishim koncerte të ndryshme, sidomos nëpër Evropë. Kulminacioni ka qenë shpërblimi i dytë botëror në Langolen të Britanisë, më duket në vitin 1977. Tani fletet se diçka nuk është në rregull në muzikë, por rrjedhimet e reja botërore ndikojnë edhe në muzikë. E të rinjtë në veçanti distan-

cohen prej muzikës tradicionale, e nëse atë e përdorin, atë e modifikojnë dhe e përpunojnë. Kjo njëjtë vlen edhe për Shqipërinë, edhe atje muzika përparon, por në rrjedhat e reja, moderne. Atje ka shumë talente, që depërtojnë jo vetëm brenda shtetit por edhe jashtë. Kjo vlen edhe për Kosovë, një numër i madh i studentëve i kanë kryer studimet në Lubjanë, Shkup, Beograd, Sarajevë, edhe në vende të tjera, e kjo pastaj krijon një konglomerat, e ndikon edhe në kuadrot edhe më të reja. Publiku ynë është më tepër i edukuar në muzikën tradicionale, mirëpo kompozitori nuk mundet të shkojë mbrapa, ai shkon në tutje, në rrjedhat e reja me kompozimet e veta, dhe është problem publiku të edukohet dhe të pranojë atë. Kemi pasur rast që publiku muzikën e re, me rezervë e ka pranuar.

Muzika e mirëfilltë në trojet tona vjen përmes kishës dhe muzikës kishtarë...

V. Gjini: Është e vërtete se muzika kishtarë, e cila nën influencë të muzikës popullore, është krijuar në një stadium, në një nivel, fushë, të lartë. Për këtë flasin edhe dokumentet, sidomos profesor Ramadan Sokoli nga Tirana. Ai i hulumton këto gjëra dhe ka hasur në shumë dokumente autentike, të vërteta, se me muzikë janë marrë priftërinjtë, kleri në përgjithësi. Edhe unë posa kam përfunduar studimet, kam filluar të shkruaj edhe muzikë kishtarë, sakrale. Në fillim jam paraqitë me pseudonimin Doni (sepse kushtet ishin të tilla, ishte komunikim), duke menduar në vëllain tim të ndjerë Don Gaspër Gjini. Kam kompozuar edhe për Nënë Terezën,

janë ekzekutuar shumë, sidomos me koret e fëmijëve, me tekst të përshtatur. Përmbledhja e parë e librit kishtar, kantual, është shtypur në Romë, Don Zef Gashi ishte redaktor i librit, e mua më pati angazhuar si profesionist, e të gjitha kompozimet e Lorenc Antonit, i ka përmbledhë një nga një. E kur më thirrri një ditë në famulli në Prishtinë më pati njoftuar, e ishin afër 80 apo 100, dhe unë punova si redaktor muzikor, e aty i nxora edhe kompozimet e mia, ishin të shumta, libri ishte voluminoz. Këngët e Lorenc Antonit i stilizova, i harmonizova si duhet, dhe sot e kësaj dite përdoren në kishë. Aty i futëm edhe disa kompozime të Gjon Gjevelekajt, Bernardina Mjedës, si dhe të Antonio Gashit, këstu që doli një përmbledhje shumë interesante dhe voluminoze, e i mirë. Pos kësaj prapë isha mjaft i interesuar për muzikën kishtarë, sakrale, dhe erdhi koha kur i kompozova njëzet e sa meshë në gjuhën shqipe. Mendoj se jam kompozitori i parë që kam kompozuar komplet meshën në gjuhën shqipe. Dhe këto dy librat që dolën të kompozimeve kishtarë, mjerisht ne nuk kemi në terren njerëz që punojnë me koret e fëmijëve ose të të rriturve për ta propaganduar më shumë muzikën kishtarë që të ekzekutohen ato kompozime, të dalin jashtë, jo vetëm të mbesin në libër. Se vetëm si libër ai nuk paraqet asgjë, nëse nuk shfletohet, nuk përdoret. E prandaj, edhe në parathënie e ceka se muziktarët duhen më tepër të punojnë që ato të ekzekutohen, sepse ne s'kemi pasur kushte. Mua më kujtohet edhe si fëmijë, muzikën kishtarë e kemi pasur në gjuhën latine. Mesha është kënduar në gjuhën

latine, këto kompozime që kanë dalë tash, janë në gjuhën shqipe. E deri tash teksti i meshës më shumë është recituar, sepse nuk kemi pasur kompozime. Pra në këtë fushë duhet të punohet që populli të njoftohet me këtë tingull të muzikës sonë.

Familja juaj është familje e kulturës dhe e shkencës, keni pasur një figurë të madhe në kishën katolike tek ne, Don Gaspër Gjini. Si e kujtoni ju Don Gasprin?

V. Gjini: Ne ishim gjashtë vëllezër, Don Gaspr i ishte i treti me radhë. Ai si fëmijë ishte i përkushtuar kishës e Zotit. Atë edhe disa kompozime të Gjon Gjevelekajt, Bernardina Mjedës, si dhe të Antonio Gashit, këstu që doli një përmbledhje shumë interesante dhe voluminoze, e i mirë. Pos kësaj prapë isha mjaft i interesuar për muzikën kishtarë, sakrale, dhe erdhi koha kur i kompozova njëzet e sa meshë në gjuhën shqipe. Mendoj se jam kompozitori i parë që kam kompozuar komplet meshën në gjuhën shqipe. Dhe këto dy librat që dolën të kompozimeve kishtarë, mjerisht ne nuk kemi në terren njerëz që punojnë me koret e fëmijëve ose të të rriturve për ta propaganduar më shumë muzikën kishtarë që të ekzekutohen ato kompozime, të dalin jashtë, jo vetëm të mbesin në libër. Se vetëm si libër ai nuk paraqet asgjë, nëse nuk shfletohet, nuk përdoret. E prandaj, edhe në parathënie e ceka se muziktarët duhen më tepër të punojnë që ato të ekzekutohen, sepse ne s'kemi pasur kushte. Mua më kujtohet edhe si fëmijë, muzikën kishtarë e kemi pasur në gjuhën latine. Mesha është kënduar në gjuhën

Të them të drejtën, ne Don Gasprin e kemi pasur si vëllain

Intervistë me Vinçenc Gjini

e mirëfilltë shqiptare e ka burimin në muzikën kishtare



e madh, sepse ai ka ditur neve të na udhëzojë e të na mësojë për shumë gjëra. Ishte shumë i zënë me detyrën që e kryente si meshtar, si sekretar e në detyrat tjera që ai i ka kryer. Kur vinte te unë në Prishtinë për të na vizituar, nuk rrinte më shumë se 10-15 minuta, nuk ndalej asnjë herë në darkë. Për 35 vjet sa isha unë në Prishtinë, ai asnjë herë s'ka ndejtur një natë te unë. Nëse e zinte nata te unë, shkonte në famullitë të Don Zefi me bujtë. Ishte tepër i përkushtuar kishës dhe detyrës së vet. Me një fjalë, ishte i shenjtë. Shpesh i thosha: Don, rri me ne, jo, ai shkonte në detyrat e veta. Unë ashtu e quaja, Don. Isha me të deri në momentet e fundit të tij. Edhe gjatë studimeve të mia në Shkup, nuk e lija pa e takuar bile disa minuta. Kur u sëmuri shkreti, unë e shoqërova me motrën time Marinë në spital në Lubjanë. Njerëzit habiteshin me të, çfarë njeriu ishte ai. Ishte aty i shtrirë edhe drejtori i dytë i Krshkës, elektranës atomike, e pyeti: kush je ti, Doni u përgjigji: jam një shqiptar. Çfarë shqiptari ti, i flet dhjetë gjuhë?! Ishte gëzuar, kur e vizitoi Arqipeshkëvi i Lubjanës me disa meshtarë të vet. Prej Lubjanës kaluam në Beograd, pak u forca, por trupi i tij kurrsesi të pastrohej prej asaj që iu derdh, ishte krejt sari. I pati pëlçitur fshikëza e vrerit dhe u helmua organizmi. Operacionin e parë e ka pasur në Shkup në spitalin ushtarak. Ata kanë pasur kuadro shumë të mirë, por më duket se aty është bërë një gabim i madh, dhe i shkreti e pagoi me krye. Pastaj, si thashë, shkuam në Slloveni, atje e hapën, e pastruan, por nuk kishte ndonjë përmirësim të madh. Doni dëshironte të dilte prej spitalit. E në fund vendosëm

të shkojmë në Beograd. Eh, duket se aty në Shkup nuk ka kaluar bash mirë, thoshte se dëshiron të shkonte si misionar, më duket se pati thënë në Stuttgart. Pas operacionit dëshiroi të shkonte te motra Karolina në Beograd. Nuk kaloi shumë e motra më tregoi se Doni nuk është mirë. E kaluam në spital atje, e kishte trajtim të mirë prej mjekëve, e trajtonin në mënyrë të veçantë, të gjithë mahniteshin me sjelljet dhe diturinë e tij. Ishte si shenjt. Derisa isha me motrën pranë tij, pesë priftërinj shqiptarë erdhën në vizitë, nuk më kujtohen emrat e tyre. Më kujtohet vetëm një meshtar që pati vdekur i ri, atij aty i ra të fikët. Të gjithë e përshëndetën, ia puthën dorën. Ai i riu doli në korridor, aty i ra të pakët dhe u rrëzua. Pati ardhur edhe ipeshkvi i Beogradit aty ta vizitonte, ia sillnin me rregull sakramentin.

Unë e ruaja çdo ditë. Më thoshte: Gjini, si po të dukem? Mirë është, i përgjigjesha. Mbasi e bën një skanim, ishte aty një motër, më dukej franceze, ajo tregoi se si ishte puna. Doni e pranoi atë vërtet si shenjtë. Atë ditë kur e vizituan ata pesë priftërinjtë, u zhatuam e leni padore shëndetin. Sepse ai vetë e ka lënë pas dorë.

Pas disa ditësh i erdhi fundi, ishim së bashku me motrën kur dha shpirt, ishte 55 vjeç. E kemi pasur idhull adhurimi, idol. Kur vdiq, e veshën me petkun e meshtarit. Ishin aty edhe disa motra shqiptare, ato kujdesoheshin për këto gjëra. Ne të familjes dikur bisedonim ku ta varrosim, në Shkup ku kishte shërbyer e ku e njihnin të gjithë, apo diku tjetër. Në Shkup, aty ku patën filluar shqiptarët katolikë të asimilohen, e ai i zgjoi, i ngjalli. Ne, familja, meqenëse dinim për disa fër-

kime mes tij e disa meshtarëve të Shkupit, vendosëm ta varrosim afër prindërve në Ferizaj. Ishte një numër i madh i njerëzve që e përcollën, prej krejt Kosovës, shqiptarë, katolikë e myslimanë, serbë e romë. Po, romët e donin, ai në Cërnaqore u thoshte meshe në gjuhën e tyre. Kështu mbaroi jeta e tij, pati shkruar shumë, edhe për Dritën shkruante. Pas disa viteve i bartëm eshtrat, kuptohet me miratimin e kishës, i varrosëm në oborrin e kishës në Ferizaj, aty ia ngritëm edhe një monument.

Ndërrojmë pak temën. Çka bëjnë shqiptarët në Kroaci?
V. Gjini: Eh, çka bëjnë! Asimilohen dita-ditës. Të shpërndarë, nuk bashkëpunojnë njëri me tjetrin. Por në përgjithësi nuk kam shumë kontakte me ta. Shteti u mundëson dhe me ligj janë të parapara të drejtat e pakicave, por sa i shfrytëzojnë këto të drejta, këto beneficione, më duket se nuk është e mjaftueshme. Ndërsa ne njerëzit e kulturës jemi numerikisht pak, e kemi Dr. Zef Mirditën në Zagreb, unë jam këtu në këtë vend të vogël, nuk merrem me dikë tjetër pos me kompozimet dhe profesionit tim muzikor. Deri tani kam punuar pesë simfoni. Simfonia është vepër e madhe, do ta krahasoja me ndonjë roman, pastaj shumë kantata e shumë vepra instrumentale, për kore, për fëmijë, vazhdoj të shkruaj muzikë sakrale. Po ashtu e kam shkruar para disa viteve një vepër të madhe për Nënë Terezën me tekst të Nol Berishës, një vepër serioze, të madhe, për solistë, kor dhe orkestrë. Kur ishte një manifestim për Nënë Terezën në Tiranë, ma patën kërkuar, mirëpo problemi ishte të përshkrimi i partiturës. Dhe kështu nuk pata fat që kjo

vepër të ekzekutohet atje.

Tash kam problem mungesën e teksteve, nuk është problemi në muzikë. E kam fjalën për muzikën kishtare. Mjaft e kam përdorur kantualin e Don Nikollë Minit, për të cilin unë është dashur si jem redaktor, ai kishte problem si me tekst si me muzikë. Në muzikë ka ligje, ka rregulla, harmonia dhe kontrapunkti i studion këto ligje. Shkencë është kjo.

Një porosi për lexuesit e Dritës?
V. Gjini: Është fat i madh që Drita është aktivizuar prapë, sepse ka pasur një ndërprerje të gjatë. Mbas vdekjes së Don Gasprit patëm biseduar me Don Lushin të krijojmë një fond për botime brenda përbrenda kishës. Ajo punë zgjati shumë shkurt, tani po gëzojem shumë që rishitas paska filluar të dalë kjo revistë kaq e madhe. Besoj se kontributin më të madh do ta japin priftërinjtë tanë të rinj që po aftësohen dita ditës e po merren me shkrime, së bashku me bashkëpunëtorë të jashtëm të ndryshëm, të lëmenjve të ndryshëm. Mua më kujtohen shumë numra të Dritës që kanë shtypur edhe muzikë, kanë shtypur këngë origjinale, si të Gjevelekajt, të mias, ka pasur edhe autorë myslimanë që shkruanin, siç ishte kolegu im Rauf Dhomi nga Gjakova, kompozitor. Ai pati shkruar edhe një meshë, komplet korale. Do të isha shumë i lumtur të ma dërgoni edhe mua Dritën, se do të gjëja materiale aty që të kompozoi në bazë të atyre teksteve. Kishim pasur mundësi edhe të bashkëpunojmë, pse jo? Kështu le të fitojë Drita në kualitet, të ketë një kriter të lartë.

Intervistoi:
Pater Ndue Kajtazi, OFM

Shkurt...

Lindi në Ferizaj me 1935. U diplomua për teori dhe pedagogji muzikore në Akademinë e Muzikës në Beograd, në Shkup studioi, dhe magjistroi në kompozim. Punoi kryesisht si pedagog në Sh.L.P. dega e muzikës dhe në Akademinë e Arteve (Dega e muzikës). Pavarësisht nga fillimet e vona krijuese ia arriti të krijonte një numër të konsiderueshëm veprash të formave të ndryshme të muzikës serioze, midis të cilave bëjnë pjesë: tri simfonitë, Simfonieta, 10 kantatet (jo të mëdha), Sonata për violinë e piano, variacionet për klarinet e piano, cikli i vogël i këngëve solo Letrat, disa këngë korale, përpunime e stilizime, Faktura e veprave të tij simfonike është e qartë, me simetri dhe ekulibr klasik, me harmoni neoromantike me përdorim të shpeshtë të bazës tonale modale dhe mjaft herë me tingëllim të melosit popullor shqiptar. Është gjithashtu autor i një numri të konsiderueshëm veprash të muzikës kishtare. Në vitin 2000 e boton veprën e tij kapitale të muzikës sakrale në dy vëllime "Ejani t'i këndojmë Zotit I dhe II", botim i Misonit Katolik Shqiptar në Zagreb, nën përkujdesjen e misionarit Don Ndue Ballabanit.

personalitet

Atë Shtjefën Gjeçovin konsiderohet njëri nga tri figurat vigane që krishterimi i fali kulturës kombëtare shqiptare. Për kontributin e tij, radhitet përkrah dy gjenive të tjerë të krishterimit në Shqipëri, Atë Gjergj Fishtës e Atë Anton Harapit.

Atë Shtjefën Gjeçovi

një jetë për

■ SHKRUAN:
Prof. dr. Jahja DRANÇOLLI

Shtjefën Gjeçovi (Mehill Kostandin Gjeçi-Kryeziu) u lind në Janjevë, qytezë në jug të Prishtinës. Në pagëzim ia vunë emrin Mehill e shkurtimisht e thirrën Hilë. Që në fëmijëri u shqua për zgjuarsin. Së këtejmi, famullitari françeskan, me leje të prindërve, e mori një ditë për dore dhe u nis bashkë me të për në Shkodër, në Kolegjin françeskan. Gjeçovi ishte vetëm 10 vjeç kur veshi zhgunin e murrmë, të lavdishëm, të fratit. Mësimet e para i mori në Janjevë, kurse të mesmen e kreu në Kolegjin Françeskan të Troshanit, për të vijuar më pas studimet teologjike në Bosnje, ku në vitin 1888 dhe (15 gusht) hyri në radhët e Urdhrit Françeskan të Kuvendit të Fojniçës. Më pas ai vijoi mësimet filozofike në Kuvendin e Derventës e të Banja Llukës dhe mësimet teologjike në Kuvendin e Kreshevës, ku u njoftua me vjershtëtarin kroat, Grga Martiq, i quajtur Homeri kroat. Pasi mbaroi mësimet (1896), ai u kthye në Shqipëri më 1896, pasi u shugurua prift, dhe kaloi pjesën më të madhe të viteve më produktive të tij (ca 1905-1920) ndër fiset e malësisë në vendbanime të ndryshme. Gjatë kësaj periudhe ai nisi të interesohet për gjithçka kishte të bënte me historinë e popullit të vet: për fillimet e krishterimit, për etnografi, arkeologji, linguistikë, letërsi e natyrisht edhe të hidhte në letër shkrimet e para, pa harruar kurrë se detyra e tij kryesore do të ishte predikimi i Ungjillit të Krishtit. Ai është një ndër shkrimtarët që e ka ndihmuar letërsinë shqipe.

Nga vargu i gjatë i librave të botuara të At Gjeçovit do të veçojmë këto: *"Dashtunia e Atdeut"* (1901-dramë), *"Shqiptari ngadhnyes"* (1904), *"Agimi i Gjytetnisë"* (botimi i saj më 1910 pati një jehonë si mbrenda dhe jashtë shtetit. A. Xhuvani nga Aleksandria i uronte me gjithë zemër për dobinë, që po i sillte gjuhës e literaturës sonë), *"Shna Ndou i Padues"*, në vitin 1912, *"Atil Regul"*, përkthim i lirë i

dramës me tri akte të Pjetër Metastasis, *"Joana d'Ark"* (1915, porosia e librit është si të mëson popullit për të dashur Atdeun), etj. Në shkrimet e mbetura të pabotuara, ndihen shqetësimet e autorit për problemet kombëtare e shoqërore: *"Shqiptari Ngadhnyes"* (1904), *"Princi i Dibrave apo Mojs Golemi"* (1904), *"Mënera e Prezës"* (1902), *"Përkrenarja e Skënderbeut"*, etj. Një pjesë e konsiderueshme të dorëshkrimeve të Atë Gjeçovit në gjendje të mirë ruhen në Arkivin Qendror të Shqipërisë në Tiranë. At Shtjefën Gjeçovi është çmuar dhe si etnolog, historian, arkeolog dhe folklorist i madh. Po e kujtojmë edhe veprën me karakter hagiografik, që meriton të njihet më shumë, si *"Shpërbleti i botës"* apo *"Jeta e Jezu Krishtit"*. Ai vetë pati mbledhur, sipas të gjitha kriterëve, të dhënat për të lartuar në elter një tjetër frat shqiptar, Atë Luigj Palaj, martir i fesë e i atdheut. Vepra *"Shpërbleti i botës"* u zbulua shumë kohë pasi që ishte shkruar dhe është ruajtur si dorëshkrim nga Imzot Nikë Prela, ipeshkëv i Kosovës. Kjo veper e ruajtur në dorëshkrim zotëron 93 faqe dhe është e pakryer, meqë plumbi i pabesë ia kishte ndërprerë jetën e Gjeçovit, cili këtë veper e kishte lënë në kapitullin e pestë me titull, "Lamtumirë". Një koinçidencë tragjike, apo një vdekje e paralajmëruar. Sikur të dinte se çka e priste, Gjeçovi e kishte nisur kapitullin kështu: "Edhe pak kohë do të shihni ndërmjet jush, o bijtë e mi. Nji urdhën të ri unë po ju nap [...] të doni njëri tjetrin, sikurse unë u deshta ju [...]. Mos të ju lanë zemra e juaj e mos të ju trembet [...]". Kështu fliste Jezu Krishti, personazhi kryesor i kësaj vepre, apo autori i saj që ishte i ndërgjegjshëm për fundin që e priste. Apo të dy së bashku, Themeluesi i krishterimit dhe kleriku shqiptar? Një gjë mund të thuhet me siguri: Kjo është vepra e fundit e shkruar nga Atë Gjeçovi në Zym, kur u vra pabesisht, derisa fletëve të këtij dorëshkrimi ende nuk iu kishte tharë ngjyra e shkrimit. Ky dorëshkrim në vitin 1993 është botuar në Kosovë nën redaktimin e Imzot Nikë Prelës me një parathënie të I. Ahmetit. Duke shkruar këtë libër Atë Gjeçovi përtërinte traditën

e shkrimit shqip të paraardhësve të tij hasjanë, si Pal Hasi, Pjetër Mazrreku, Ndre, Pjetër dhe Lukë Bogdani. Vepra zotëron elemente të qëndrueshme biblike, teologjike, filozofike e letrare-stilistike të traditës tonë dhe traditës evropiane. Kjo veper do të mbetet si veper monumentale në letërsinë kishtare shqiptare. Atë Gjeçovi, ndër të tjerë, ka shkruar një veper që i kushtohet Shën Luçisë, shenjtorese së kishës katolike të Durrësit, *"Jeta e Shë Luçis pajtores s'arkidjozëz të Durrësit"*, i botuar në Shkodër më 1904, në shtypshkronjën e Zonjës së Zanun pa mëkat të rrjedhshëm.

“ Patër Shtjefni pasi u shugurua prift, e kaloi pjesën më të madhe të viteve më produktive të tij (ca 1905-1920) ndër fiset e malësisë në vendbanime të ndryshme. Gjatë kësaj periudhe ai nisi të interesohet për gjithçka kishte të bënte me historinë e popullit të vet: për fillimet e krishterimit, për etnografi, arkeologji, linguistikë, letërsi e natyrisht edhe të hidhte në letër shkrimet e para, pa harruar kurrë se detyra e tij kryesore do të ishte predikimi i Ungjillit të Krishtit. Ai është një ndër shkrimtarët që e ka ndihmuar letërsinë shqipe. ”

Libri ndodhet në Bibliotekën Kombëtare, Tiranë. Titulli i plotë i veprës është "Pajtorja e Durzit A Sc'Lucia". Atë Gjeçovi shkroi edhe një veper tjetër me përmbajtje teologjike, që mban titullin *"Buzmi Bujar"*, veper kjo, e cila konsiderohet një përmbledhje me rite dhe doke të popullit shqiptar të vjela gjatë viteve 1900-1926. Në hyrje të kësaj vepra ruhet ky shënimi i Gjeçovit: "Në këtë fletore përmbledha ca rite e doke që i kisha nëpër fletë që të mos më shkojë puna dam dhe literatura shqipe të mos varfërohet. Gjakovë 23. VI. 1927". Përgatiti Atë Gjeçovi edhe veprën monumentale, *"Kanuni i Lekë Dukagjinit"*, pjesë të së cilës u botuan me gjallje të tij në revistën "Hylli i Dritës" (1913). Pas vdekjes së Gjeçovit dorëshkrimet e tij u mblodhën, u radhitën dhe u shtypën nga shtypshkronja françeskane e Shkodrës (më 1933) në një vëllim të vetëm me një parathënie të Gjergj Fishtës. Kjo veper është një monument i gjuhës e i kulturës së Kombit Shqiptar, për të cilin Universiteti i Lajpcigut i dha titullin "Doktor i shkencave - honoris causa". Ndërkaq, profesori i Universitetit

të Mynihut, Claudius Scherwing jep një vlerësim të lartë kanunit, duke e konsideruar se ligjet që dalin nga ky, janë shumë interesante, mbase janë më të vjetrat në Evropë dhe Evropa duhet ta njohë se ç'ka përfutur kombi i vogël shqiptar për vërimet e mëdha të kulturës. Pas veprave origjinale dhe të përkthyer, Gjeçovi shkroi edhe shumë studime në revistën "Albania" të Brukselit e të Londrës, në "Hylli i Dritës", etj. Atë Gjeçovi ka botuar njëmbëdhjetë poezi në revistën "Albania" të F. Konicës, me pseudonimin "Lkeni i Hasit" (më 1900 botoi vjershën "Thana"; më 1901,

u botuan vjershat *"Qyqë"*, *"N.B. Frashëri"* dhe *"Hiria e Gjergj Kastriotit"*; më 1902 *"Udhë mar"*, *"Pse"*, *"E drejta"*, *"Dashtunia e Atdeut"*, *"Hylli i ri"*, *"Shqypnia e Shqyphtarit"*, *"Beja e Shqyphtarit"*. Nga viti 1919 e tutje, puna e Gjeçovit në mblidhjen e vargjeve gojore u vazhduar nga një françeskan tjetër, Bernardin Palaj (1894-1947). Gjeçovi mblodhi këngë folklorike gjatë udhëtimeve të veta këmbë nëpër bjeshkë dhe shkroi artikuj mbi traditën dhe kulturën gege dhe zakonet fisnore. Ai u dha sidomos pas *"Këngëve Kreshnike"*, të cilave u kushtoi pjesën e madhe të potencialit të tij intelektual. Bashkë me Donat Kurtin (1903-1983), Atë Gjeçovi botoi koleksionin më të rëndësishëm të vargjeve epike shqiptare deri sot, "Kangë kreshnikësh dhe legjenda", të cilat u botuan në Tiranë në ciklin "Visaret e Kombit" më 1937 për të shënuar 25-vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë. Puna e Gjeçovit është në vazhdim e veprimtarëve të Rilindjes për të mblidhur e për të dëshmuar traditat kombëtare dhe lashtësinë historike të shqiptarëve, kulturën e tyre materiale dhe shpirtërore,

O FM, fe e atdhe

Fotografi e zbuluar kohët e fundit nga Don Nikson Shahani



Dorëshkrim origjinal i Atë Shtjefën Gjeçovit ►

për të lëvruar fjalën shqipe dhe për të forcuar vetëdijen kombëtare të popullit të vet. Kjo epokë e artë e kulturës dhe studimeve u ndërpre përnjëherë me ardhjen në pushtet të komunistëve në Shqipëri më 1944. Të gjitha institucionet kulturore dhe arsimore të Kishës katolike u mbyllën dhe shumë studiues dhe shkrimtarë më të mirë të Shqipërisë, mes tyre edhe Bernardin Palaj, Ndoc Nikaj (1864-1951), Vinçenc Prenushi (1885-1949), Anton Harapi (1888-1946) dhe Gjon Shllaku (1907-1946), u likuiduan fizikisht ose vdiqën në burg. Periudha menjëherë pas lufte ishte bërë një apokalips për shkrimtarët dhe intelektualët shqiptarë. Sa ishte e bujshme veprimtaria e tij letrare-shkencore, po aq ishte e bujshme edhe ajo meshtarake. Së këtejmi, Atë Gjeçovi shërbeu si famullitar në Troshan (1896, 1905-1906, 1915-1916), famullitar i ri me fe të gjallë e kulturë të thellë. Predikoi Ungjillin në Rubik (1896-1897, 1919-1920, 1920-1921. Këtu, më 1921 Gjeçovi e shkroi veprën "Sebaste n'Arbeni apo n'Armeni", si dhe i qaset çështjes së një kishëze të moçme të Rubikut nga viti 1250), Pejë (1897-1899, 1819-1920), Laç-Sebaste (Kurbin 1899-1905), Zarë (1905-1906), Sapë (Zadrimë 1915-1916), Theth (1916-1917), Prekal (1917-1918), Vlorë (1920-1921), Shkodër (1921-1926), Gjakovë (1926-1928), Gomsiqe të Mirditës (1907-1915, Këtu, Atë Gjeçovi dhe Gjergj Fishta bënë që Kisha e Gomsiqës të shndërrohej në një institut të vërtetë hulumtimi shkencor), Zym (30 maj 1928 deri më 14 tetor 1929), etj.

Atë Shtjefën Gjeçovin konsiderohet njëri nga tri figurat vigane që krishterimi i fali kulturës kombëtare shqiptare. Për kontributin e tij, radhitet përkrah dy gjenive të tjerë të krishterimit në Shqipëri, Atë Gjergj Fishtës e Atë Anton Harapit. Një nga figurat më poliedrike që njeh historia e kulturës shqiptare, ai pati etjen e pashuar të gërmonte nga pak edhe në të gjithë lëmenjtë e shkencës. Mahniti me kulturën e tij, F. Konicën, i cili e përshkruan me nderim të thellë në parathënien e Kanunit; mahniti edhe shkrimtarin, Dom Lazër Shantojnë, edhe ky martir i krishterimit gjatë diktaturës, i cili i kushtoi portretin më të bukur

që është shkruar për të, duke e radhitur përkrah Fishtës e Harapit. Ai mbeti në kujtesën e të gjithëve si një nga historianët, etnografët dhe arkeologët e parë shqiptarë. Kjo veprimtari e bujshme kundër synimeve shkombëtarizuese serbe ndaj popullsisë e religjionit dhe kulturës shqiptare u bë shkak, që të bie në sy të rretheve shoviniste serbe, të cilat organizuan në afërsi të Zymit vrasjen e tij më 14 tetor 1929. Lajmi i vrasjes së Gjeçovit lëndoi zemrat e të gjithë shqiptarëve, meqë, të gjithë e donin dhe e çmonin për kontributin e tij për Fe dhe Atdhe. Serbët nuk u kënaqën vetëm me vrasjen e Shtjefën Gjeçovit, shkruante më 30 janar të vitit 2000, "L'Osservatore Romano", meqë në të njëjtën mënyrë u sollën edhe komunistët me eshtrat e Jak Serreqit, Lazër Mjedës, Gaspër Thaçit, Ernest Cozzit, Bernardin Shllakut e Gjergj Fishtës.

Atë Gjeçovi u mor edhe me arkeologji, që nga viti 1900 deri më 1920. Sipas Gjeçovit, "arkeologjia asht një argtim i kandshem, sa asht i kandshem, aq asht i vjefshem [...] për historin e çdo kombi" (Zani i Shna Ndout", Dhkodër 1920, vjeti VIII, nr. 4). Kërkimet arkeologjike Gjeçovi i realizoi anë e kënd Shqipërisë, si, në Laç, Mat, Koman, në Kala të Dalmacës, Milot, Troshan, rajonin e Hasit, Arrëz (Hot), Koleksioni arkeologjik i Gjeçovit i mbledhur dhe i sistemuar përfshin në më se 500 eksponate nga të ndryshmet. Nga ky koleksion, mua më pëlqen të veçoj, sidomos këmbanën e Gjergj Kastriotit-Skënderbaut nga një kishë e Krujës nga viti 1463, si dhe një unazë ari me një mbishkrim nga Komani. Ai zbuloi gjithashtu tuma ilire dhe mbledhi artefakte të moçme, si dhe monedha ilire me një shije e kujdes të posaçëm prej erudit. Vjetërsitë që ai zbuloi dhe i mbledhi, tërhoqën vëmendjen e shumë studiuesve të atëhershëm dhe të sotëm, si Atë Vinçenc Malaj, Hasan Ceka, Ruzhdi Mato, Karl Patch, Franc Baron Nopca, Theodor Ippen, Camillo Praschniker, Luigi Ugolini, etj. Talenti i Gjeçovit u shpreh edhe në lëmin e skulpturës. Së këtejmi ai skaliti në dru. Shkopi i tij është bërë i njohur si veper artistike, i cili ruhet sot në Muzeun e Shkodrës.

"... Nuk kishte me kenë për mue me u kapun ndër do degë dituniet, t'cilvet nuk jamë kenë vuc me u kërkue as me u hetue skain, porse nuk m'rrihet pa i çilë këtë gojë e pa i piskue dy fjalë mbi ato sende t'vjetra, t'cillat i kam edhe i ruc nën kulm t'shpis seme e t'cillat ai kam gjet vetë a m'i kan pru me pak çmim disa njerëz t'kombit tem me një t'pakeqesi sikurse i gjejshin a ndër vorre a ndër rrënime t'vjetra.

Ma i madhi mjerim për vendin tonë asht vorfrimi prej një visari ma t'cmueshëm e ma t'vlershëm si janë vjetërsinat. Këto q'i i kanë ndeje nën dhe kush e din sa mija vjet, qi kan ba gjumin e ambël ndër hejt t'atyne burrave që janë kenë ndërë e faqja e bardhë e vendit tonë, e sod lenë si ato sende pushojnë ndër vjetërsore t'hueja, por deri hejt e atyne burrave qi pushoshin në gj'i t'tokës shqiptare u janë shpërnda e i ka hjedhë era më tutje si ate me fry e me koc e me rasht janë marrë neper kame.

Ma i madhi e ma i papërdëlyeshmi faj i shqiptareve tonë asht qi ato sende t'vjetra t'gjetme n'tokë ndër vorre t'lashta i lëshojmë duarrsh tuj ja shiun t'huejve, e kta për do çmime t'ngrata fare.

Ky faj s'mund t'ju shkruhet malësorëvet a katundarëvet, për arsye qi ktyne s'u kupton mendja ma larg e s'dinë me i peshue ato hollime e imtime historiet si i dimë e do t'dimë na qi kena kalue disa mot ndër msojëtove. Për një mend se t'pa rregjun jena edhe na qi kena xanë dije ndër msonjëtove, porse në u rrejshim një herë, mendja na p'priet për tjera herë. Gabojmë një herë, por një tjetër shteg s'do t'gabojmë.

Po qes vedin për tregim tuj ju rryfe hutimin tem i n'daçi edhe marrijen teme t'bame, po një herë t'vet me në vjetin 1900.

Isha n'Laç - Sebaste të Kurbinut si i parë famulliet, si gjejshë t'knaqun n'kërkim të vjetërsienave, përm'i t'cillat tash flas, mu be në qelë Dr. Paal Traeger prej Zehlendorit t'Berlinit. I vleri anthropolog e arheolog, i cilli at bote pat fillue dishka me belbue talianisht, e unë si burrë i madh (!) xuna me ju lëndue për do sende t'vjetra t'cillat i pata gjet mun në at'kohë me një vorr në vend t'qytun "Kodër Bogëz" n'katund të Laçit - Sebaste.

Dr. Traegeri m'u lut me ja dftue visarin tem, edhe unë me njerëzje ja qita përpara. E pytshja herë për një send, herë për një tjetër, e ky rrap-cap me atë gjuhë taliane, u mundote me m'i kallzue do punë përm'i ato vjetërsiena. Ndër këto sende kishë edhe një unazë arit t'cillen e pata gjetë n'vorre t'vendi të përmendun. E pyeta Dr. Traeger - in qit' më dftonte kohën e vjetërsienës së saj, e ky m'u përgjegji: "kohën e vjerën s'mund ta kallzosh, se na arheologët jena të betuem me mos kallzue as kohën as çmimin e vjetërsiet, por po deshe me e shit, unë po të nap një 7 (shtatë) napolona për atë unazë".

Të falëm ndërës, i thaçë Dr. Traeger-it, - me më dhanë 400 napolona s'e shes, por veç deshta me ditë kohën e çmimin e vjetërsies."

kritikë letrare

Letërsia e Atë Gjergj Fishtës (IV)

Gjergj Fishta është autori i përmasave universale, sa do që karakteri i letërsisë së tij, të shumtën e herëve, zhvillohet në suaza të qenies së botës shqiptare dhe nuk largohet shumë nga topika ekzistenciale nacionale, pra trajtimi i temave që lidhen me etnikumin. Në këtë aspekt, letërsia e tij ndërlihet pashmangshëm me një kontekst të caktuar shoqëror. Kësaj edhe u përgjigjet natyrshëm zhvillimeve të kohës. Sidomos këtë përmasë e ndeshim më fuqishëm te "Labuta e Malcis", në të cilin tekst letrar, Fishta shpërfaq fuqishëm dhe hapur qëllimet jashtëletrare dhe kështu arriti të ndërtojë një rrjet paradigmatic letrar që ndërlihet me Shenjën Letrare, që përbëjnë Strumbullarin e binomit përshkues letrar: Atme e Fe, që do të bëhet, në kuadër të letërsisë së Fishtës, një kod i madh letrar, i ndjekur edhe në strukturat ligjërimore.

■ SHKRUAN:
Ndue UKAJDimensioni semantik
dhe estetik në letërsinë e
Fishtës

Teksti letrar, "genia e letërsisë së tij", ndërtohet mbi dy kategori esenciale, të cilat njëherit janë preokupim i vazhdueshëm në fushën e interpretimit të letërsisë: aksi semantik dhe aksi estetik. Kualifikimi i parë ndërlihet me idetë, kuptimet, ngjarjet, rrjetin narratologjik (mënyra si thuret ngjarja nga këndvështrimi i *diegesisit aristotelian*), dhe kualifikimi i dytë ndërlihet me rrafshin e mënyrës së si janë manifestuar në tekstet letrare elementet konstituive estetike, elemente këto që janë të natyrës gjuhësore, stilistike, përgjithësisht atë që mund ta konceptonim gramatikë e teksti letrar. Këto dy komponentë, të cilat i përmendëm, implikojnë dy nivele të leximit të tekstit letrar, të cilat Umberto Eco i shtron në kuadër të nivelit të *leximit semantik dhe leximit estetik* të tekstit letrar. Po ashtu, kategoritë e lartshkruara sugjerojnë edhe dy akse të mundshme të interpretimit të letërsisë pas procesit të leximit dhe gjenierimit të kuptimeve në tekste të caktuara letrare. Duke operuar me këtë kuadër termash (nacionesh) letrare, letërsinë e Fishtës e dimensionojmë në dy segmente, të cilat i identifikojmë tek tekstet letrare të fushave themelore të letërsisë së tij: në epikë, lirikë, dramatikë dhe satirikë. Në këtë korpus tekstesh, dy kategoritë e përmendura, paraqiten në plan të ndryshme dhe dalin në funksion të përbushjes së idesë finale të tekstit, pra asaj që i është statusi letrar. Prandaj edhe shqyrtimi-kuptimi i letërsisë fishtiane, përmes këtyre dy kategorive, bëhet për të specifikuar dy përbërës themelore të letërsisë së tij, që janë:

1. Dimensioni semantik
2. Dimensioni estetik

Ky kategorizim, në pikëshikim të një analize tekstuale, synon sintetizimin e funksioneve semantike dhe estetike, në strukturën apo strukturat shumështrësore

të teksteve letrare të autorit. Po ashtu, këto dy kategori letrare, prekin logjikën e funksionimit të teksteve letrare të Fishtës, në planin qëllimor që shtron ai para objektit të quajtur letërsi. Në fakt, niveli semantik dhe niveli estetik i tekstit, jo vetëm që janë pjesë e strategjisë autoriale, në një analizë më të gjithanshme, shprehin esencën e letrarisë së Fishtës, letërsi kjo që ngërthen në vetë këto dy boshte si elemente të fuqishme: teksti të ketë ide, mesazh letrar dhe konfigurim estetik letrar. Këtë pikësynim mbase autori e funksionalizon për të realizuar konceptin aristotelian për letërsinë: *Katharsis-in*. Në të vërtetë, kjo intencë letrare ndërlihet me misionin e autorit në shkrim, mision ky që ndeshet në të gjitha zhanret letrare, në të gjitha mënyrat e artikullimit të diskutit, që për pandehmë ka prototipin e *Misionarit Biblik*, që studiuesi amerikan Northrop Fraji e analizon në kontekstin e figurës kryetipore të bariut të mirë biblik. Këto dy nivele të konfigurimit të tekstit të Fishtës, kurdoherë pikëtakohen dhe realizojnë fuqishëm poetikën letrare. Sidomos në tekstet narrative (epikë), ku idetë, kuptimet, ngjarjet kanë rol predominant, përpiqen njëra me tjetrën dhe konstruktojnë tërësinë letrare. Këtë tip të shkrimit Fishta më fuqishëm se kudo në tekstet e tij, e plasoi në epikë, te "Labuta e Malcis". Në këtë tekst, përjekja e autorit për të harmonizuar idenë (ngjarjet) me mënyrën e thënies (nivele retorik/poetik dhe estetik e stilistik), mbetet një ndër karakteristikat e stilit fishtian. Në këtë aspekt, sekuencat narrative realizojnë nivelin letrarisë, asaj që Zherar Zheni i thotë "genia e letërsisë", të epit në falë. Këtë logjikë autori e ndërton përmes idesë së projektuar, që njohu paramodelin. Në epikë, ky model për shembull ka për bazë së pari rrefimin sipas tipave të epëve të lashta (*Iliada* dhe *Odisea* të Homerit dhe *Eneida* e *Virgilit*), së dyti, ka pikëmbështetje trashëgiminë e pasur vendëse (formë kjo që rezultoi në mënyrë eksplicite prej

letërsisë orale) dhe që ndeshet në krijimtarinë e Fishtës në formë të diskutit oral, që, të bashkuara në shtratin narrativ, konfigurujnë statusin final të "Labutës së Malcis". Këto elemente letrare gërshetohen, thithen, hibridizohen, mbivendosen dhe shpërndahen (ridistribuhon) në ligjëratën letrare përmes emocionalitetit poetik, të ndjenjës së thellë lirike dhe të fuqisë së diskutit epik.

Në librin "Bërja e analizës së diskutit" (*Doing discourse analysis*), autorët Linda A. Wood dhe Rolf O. Krogër, shpjegojnë modelet të ndryshme të bërjes së analizave të diskutit. Në këtë kontekst, autorët flasin për "strategjinë e interpretimit", si orientim efektiv për të analizuar funksionin e diskutit brenda një veprë letrare. Kjo mënyrë e shpjegimit

stilit letrar fishtian, në planin e ligjëritimit, dhe idesë së hetimit të tipave të diskutave brenda strukturës së tekstit konkret.

Letërsia e Fishtës synon të jetë funksionale. Ky term në fakt prek dinamikën e teksteve, në procesin e gjenierimit të kuptimit. I kontekstualizuar në tekstet letrare të Fishtës, termi përbën një komponent me rëndësi, për faktin se nënkupton funksionet që pretendojnë të luajnë tekstet e Fishtës në audiencën. Sidomos atëherë kur rrjeti i këtyre shenjave si kode letrare (semiozave sipas *Ecos*) në tekst funksionalizohen më qëllim të prodhimit të kuptimeve letrare të caktuara, çfarë synonte autori.

"Veprat letrare na ftojnë ka liria e interpretimit, sepse na propozojnë një diskurs shumëplanësh të

Letërsia e Gjergj Fishtës zhvillohet brenda një periudhe kohore relativisht të gjatë dhe me zhvillime dramatike për popullin e tij. Në kuadër të këtyre zhvillimeve, autori botën e tij artistike nuk e përqendroi vetëm në epikë, por sprovoi talentin dhe fantazinë krijuese në lirikë, dramatikë dhe satirikë, për të mos lënë anash as tekstet e shumta diskursive, socio-psikologjike, etno-psikologjike, religjioze, politike etj. Madje edhe tekstet metakritike të aspektit teorik për artin dhe qenësinë e tij. Në gjitha shkëlqeu në mënyrën e vet, duke formësuar stilin e veçantë poetik e letrar. Me një diskurs të kondensuar estetik pikasi ndjeshmërinë e kohës, duke i bërë dhimbje e kërkesa universale. Fishta, duke i riinterpretuar në një kontekst letrar e kulturor, kontekstualizim të teksteve të njohura letrare u jep konitime aktuale, ku pikasen fuqishëm idetë me shpërthim të tij letrare, që kërkojnë përbushjen e intencionalitetin ideor, nëpërmjet shenjave e simboleve letrare e të cilat kurdoherë korrespondojnë me projektin letrar fishtian për emancipim e kulturim të gjithmbarshëm të kombit e fesë, mision ky që kapërcen kufijtë letrarë dhe bëhet paradigmë krijuese, e papërsëritshme, në letrat shqipe.

të diskutave në tekstet letrare të Fishtës, është orientim bazik dhe funksional, i cili në të njëjtën kohë mundëson të aplikohet si metodë e mundshme që kërkoni mënyrën e funksionimit të tek-

leximit dhe na vënë përballë ambiguitetit të jetës dhe gjubës" shkruan Umberto Eco. Në këtë mendim, Eco identifikon dy koncepte esenciale: *ambiguitetin e diskutit dhe jetës*. Ky i fundit kap statusin

e empirisë letrare. I pari ndërlihet me tekstin. I dyti me autorin empirik dhe psikologjik. Kësore, ligjëratat poetike e Fishtës, në instancën letrare derdh në shtratin e botës narrative letrare, shumëplanëshin e diskutave të jetës dhe empirisë letrare, drejt qëllimit final të tekstit, që prodhon ambiguitetin e gjubës letrare. Në letërsinë e Fishtës ka polidiskurse letrare. Teksti fishtian artikulohet nga një referencë, pastaj merr statusin autorial.

Paradigma letrare Atme e Fe - universi Letrar Fishtian

Gjergj Fishta është autori i përmasave universale, sa do që karakteri i letërsisë së tij, të shumtën e herëve, zhvillohet në suaza të qenies së botës shqiptare dhe nuk largohet shumë nga topika ekzistenciale nacionale, pra trajtimi i temave që lidhen me etnikumin. Në këtë aspekt, letërsia e tij ndërlihet pashmangshëm me një kontekst të caktuar shoqëror. Kësaj edhe u përgjigjet natyrshëm zhvillimeve të kohës. Sidomos këtë përmasë e ndeshim më fuqishëm te "Labuta e Malcis", në të cilin tekst letrar, Fishta shpërfaq fuqishëm dhe hapur qëllimet jashtëletrare dhe kështu arriti të ndërtojë një rrjet paradigmatic letrar që ndërlihet me Shenjën Letrare, që përbëjnë Strumbullarin e binomit përshkues letrar: Atme e Fe, që do të bëhet, në kuadër të letërsisë së Fishtës, një kod i madh letrar, i ndjekur edhe në strukturat ligjërimore.

Letërsia e Fishtës përfaqëson njërin ndër korpuset më specifike në literaturën shqipe, përgjithësisht. Në kontekstin e kontinuitetit letrar, shënjon dhe avancoi ndërlihdjen e fuqishme letrare me traditën gege të kulturës e shkrimit letrar, kulturë kjo letrare, e cila shtresoi elementet bazike për gjithë kulturën e letërsinë shqipe, shpërndëruar në pikëpamje të kodeve tematike, të cilat ndërlihet me autorët klasikë (*Buzuku, Budi e Bogdani*), të cilët autori Anton Berishaj i vlerëson me formulimin e qëlluar se këta autorë përfaqësojnë themeluesit e kulturës tekstuale shqiptare,

kulturë letrare dhe estetike kjo, e cila zhvillohet brenda një shtrati specifik, përmes letërsisë së arbëreshëve të Italisë, dhe që më tej merr vullën përmes autorëve modernë të viteve të 30-ta, të cilët përfaqësojnë themeluesit e modernitetit në kulturën letrare shqipe, bashkautor i së cilës është Gjergj Fishta me korpusin e tij letrar, roli i të cilit shkrimtar në letërsinë shqipe do të jetë i rëndësishëm dhe shumëplanësh. Mbase, për shumëçka autori më influencues. Madje këtë kulturë letrare, autori do ta avancojë në pikëpamje poetike dhe zhanrore në një shkallë të lartë dhe të paarritshme. Kjo frymë zhvillohet edhe më tej, përfundimisht, me zgjerime në kodet ligjërimore. Pikat e përbashkëta interletrare sforcohen përmes Fishtës në formën poetike të shkrimit, në vargje, dhe Koliqit, Camjat e Pashkut në prozë. Shënjes i përbashkët i kësaj literature, mbetet intencja e shkrimtarëve për të qenë misionarë në ide dhe në angazhime konkrete. Të Fishta kjo del në mënyrë eksplicite. Ndërsa tek autorët tjerë është i fshehur në ndërtekst (përmes trajtave implicite). Këtu edhe njëherë vetëm sa na ripërsëritet mendimi i Çabejit, se poetit në të njëjtën kohë i duhet të jetë edhe prijës, apostull dhe bari i kombit. Dhe në të njëjtën kohë shkrimtar. Veçmas kjo hetohet te letërsia e Fishtës. Dhe më pas, te letërsia e Nolit, letërsi që në pika të përbashkëta, edhe pse

zhvillohen në kontrast, pretendojnë të ndërtojnë heroin, misionarin, që hidhet edhe për tej letërsisë, në angazhimet konkrete shoqërore. Noli i kërkon në personalitet, ndërsa Fishta në dy akse, në shpirtin e popullit dhe te personaliteti historike. Në të vërtetë ky fenomen nëpër kohë do të bëhet karakteristikë letrare në shtratin e topikës mbizotëruese të letërsisë shqiptare. Nëse do të synonim të kërkonim një paradigmë të përbashkët në universin poetik të letërsisë së Fishtës, si nyje që ndërlidh insetet e letërsisë së Fishtës, atëherë ideja e kulturim të gjithmbarshëm e emancipim për liri të njëmendtë e shfaqur kurdoherë, dhe atë, me përmasa të gjithanshme, në substratin e të cilit formulim implikohet formula esenciale, e cila determinon poetikën letrare të Fishtës, pra formula e shënjuar përmes binomit paradigmatic letrar e estetik: *Atme e Fe*. Ky binom do të bëhet model organizues i teksteve të autorit në shumë nivele dhe me përmasa funksionale. Paradigmë kjo që shenjëzohet përmes kërkesës patetike fishtiane, për rinjohje të vlerave nacionale, përmes identifikimit në strumullarin *Atme e Fe*. Ky binom letrar endet në letërsinë e Fishtës me status intencional dhe përbën esencialitetin e ligjërimit letrar. Në fakt, përtej dy termeve/koncepteve abstrakte, ky binom në letërsinë e Fishtës do të bëhet paradigmë/shenjë letrare, figurë poetike edhe kur ka përdëgëzime

intretreksuale e interdiskursive. Me këtë formulim, gërshtohet edhe filozofia e qenësimit kombëtar, në planin e diskursit historik. Njëherit bëhet domosdoshmëri edhe në dritën e së ardhmes. Ky kulturim në tekstin epik, ka për qëllimin edukimin dhe emancipimin kombëtar, ndërsa në tekste lirike dhe dramatike, mbithekohet nga pretendimi për edukim dhe kulturim fetar, në pëmbushje të misionit të përbashkët: *Atme e Fe*, që lidhet me Atdehun dhe Kishën. Kjo paradigmë krijuese, siç vlerëson Injac Zamputi mbetet "*fanari i jetës së tij, që sinteza e artit dhe filozofisë së tij*". Andaj tekste të Fishtës ruajnë fuqishëm shenjat e mishërimit me misionin, duke identifikuar plotësisht me misionarin. Me këtë formë të shkrimit, autori vetëm se aplikon teorinë që analizon arketipat letrarë, përmes formulës së *Bariut të Mirë*, e cila sipas Northrop Frajtit nënkupton figurën kryetipore të *Bariut të mirë Biblik* (Jezu Krishtin), një figurë retorike kryetipore që evokon dhe e cila sublimon kërkesat e intencës letrare, pas së cilës ec letërsia e Fishtës. Kjo intencë, në statusin letrar të teksteve të autorit, është esenciale, në të njëjtën kohë e nxjerr autorin nga vetvetja dhe e hedh në labirintet e kërkimeve të tij, edhe jashtë letrare. Gjithëherë përmes tendencave artistike/letrare. Kësisoj, autori arrin të krijojë ambivalencën e gjuhës dhe ligjërimit. Me ku-

jdes të sofistikuar merr rolin e bariut të grigjës së tij, si bari shpirtëror i popullit të tij, por asnjëherë duke tejkuluar rrethanat e përgjithshme. Ideja e bariut të mirë funksionalizohet në mënyrë implicite te *Kënga e Patër Gjonit* në "*Lahutën e Malcis*", në të cilën autori vetë identifikohet me narratorin, merr përmasat e tij mbi supe, në rrugën e lirisë së kombit dhe fesë, duke implikuar një rrjet shenjash interdiskursive të modelit biblik e religjioz. Më tej, kjo ide funksionon për mrekulli në personazhin e tragjedisë "*Juda Mukabe*" dhe në përgjithësi në tragjedinë në fjalë. Vetëflimin e heroit *Juda Mukabe* në këtë tragjedi implikon autorin dhe qëndrimet e tij karshi rrethanave të kohës dhe kontekstit të përgjithshëm shoqëror e kulturor të shqiptarëve. Përmes ligjërimit dramatik, autori trah ndër temat më të rëndësishme të kohës: tradhtinë, mohimin e mikut, nevojën për vetëflim. Rrjedhimisht, këtë segment letrar e ndeshim edhe në fushën e lirikës, sidomos te personifikimi autorial, i cili shkon deri në nivelin e vetëflimit për atdehun, kur jepet kushtimi në vargjet: "*Qe mue tek m'kni, merreni e m'boni fl*", ("*Surgite mortu, Qohuni të vdekuni*"). Në këtë formë Fishta shkroi letërsi për të mishnuar filozofinë e tij të Kulturimit.

Letërsia e Gjergj Fishtës zhvillohet brenda një periudhe kohore relativisht të gjatë dhe me zhvillime dramatike për popullin

e tij. Në kuadër të këtyre zhvillime, autori botën e tij artistike nuk e përqendroi vetëm në epikë, por provoi talentin dhe fantazinë krijuese në lirikë, dramatikë dhe satirikë, për të mos lënë anash as tekste të shumta diskursive, socio-psikologjike, etno-psikologjike, religjioze, politike etj. Madje edhe tekste metakritike të aspektit teorik për artin dhe qenësinë e tij. Në gjitha shkëlqeu në mënyrën e vet, duke formësuar stilin e veçantë poetik e letrar. Me një diskurs të kondensuar estetik pikasi ndjeshmërinë e kohës, duke i bërë dhimbje e kërkesa universale. Fishta, duke i riinterpretuar në një kontekst letrar e kulturor, kontekstualizimit të teksteve të njohura letrare u jep konotime aktuale, ku pikasen fuqishëm idetë me shpërthimet e tij letrare, që kërkojnë pëmbushjen e intencionalitetin ideor, nëpërmjet shenjave e simboleve letrare e të cilat kurdoherë korrespondojnë me projektin letrar fishtian për emancipim e kulturim të gjithmbarshëm të kombit e fesë, mision ky që kapërcen kufijtë letrarë dhe bëhet paradigmë krijuese, e papërsëritshme, në letrar shqipe. Formula poetike, binomi i shenjtë: *Atme e Fe* përtej kuptimeve ideore, është shenjë që përcakton letërsinë e tij. Si e tillë, formula bëhet shënjes i letërsisë fishtiane në të gjitha planet dhe në të gjitha zhanret letrare. Dhe përcakton diskutet, trajtat e ligjërimit, stilin dhe kuptimet letrare. (Fund)



Atë Shitjefën Gjeçovi, Atë Gjergji Fishta,
Atë Justin Rrota, Atë Karl Prenusha

Atë Martin Gjoka – Krijues i parë i eposit të muzikës sakrale katolike në gjuhën shqipe

Muzika e kompozitorit Atë Martin Gjoka, është muzikë me emocione hyjnore, muzikë kuptimplote, muzikë me një ndjesi për folklorin tonë muzikor të bazuar në gamën e eposit popullor si relik i shprehjes gjithëkombëtare.

■ SHKRUAN:
Akil KOCI

Se sa është historia e spamëshirshme ndaj krijuesve të shumtë, jo vetëm në krijimtarinë muzikore, por edhe në artet dhe shkencat e shumta, na flasin shumë fakte. Kështu, bie fjala, gjenialiteti i Bahut është zbuluar pas plot njëqind viteve, e sot përfaqëson kompozitorin më të dalluar në tërë krijimtarinë muzikore.

Edhe me fratin Atë Martin Gjoka OFM, i cili ka qenë njëri prej figurave më të shquara në pesëdhjetëvjetëshin e parë të shekullit XX, ndodh e njëjta gjë, jo nga historia, por nga regjimi obskuranist, gjakatar, i cili jo vetëm që persekutoi popullin e vet, por vrau mbi 10 mijë njerëz e në mesin e tyre edhe shumë intelektualë të të gjitha profesioneve e sidomos ka vënë në shënjestër dhe ka zhdukur shumë priftërinj katolikë, të cilët kanë qenë ajka e inteligjencës sonë. E gjithë kjo që thamë, më së mirë mund të lexohet në shumë libra botuar me këtë rast e sidomos në librat e Atë Zef Plumit OFM, me titull "Rrno vetëm për me tregue" dhe në dy librat voluminoze të Dr. Pjetër Pepës me titull "Tragjedia dhe Lavdia e klerit katolik në Shqipëri". Kjo kohë mbetet si një rast pa presedan për veprimet çnjerëzore ndaj popullit të vet të papara në historinë e njerëzimit. Fatqësisht, edhe bota e muzikës me krijuesit e saj e ka pësuar rëndë gjatë kësaj epoke të errët komuniste.

Edhe kompozitori, intelektual, eruditi Atë Martin Gjoka OFM, ka qenë njëri prej krijuesve të shquar që është hequr nga plan-programet shkollorë dhe nga të gjitha aktivitetet muzikore në Shqipërinë komuniste. Dhe me të drejtë kompozitori dhe muzikologu Sokol Shupo thotë: "I lanë mënjanë në kohën e komunizmit, vepra e tij, pa pretenduar të jetë një fenomen tipik i periudhës në fjalë, përbën një dokument të çmuar të fillimit të muzikës profesioniste shqiptare" por figura e tij e madhe, edhe pse krijues me vlera të larta është zhdukur, anashkaluar me qëllim vetëm e vetëm pse ka qenë frat, dhe nëse bëjmë sintezën e kohëve, vepra e

tij si krijues i shquar ka folur dhe trajtuar tema pos atyre shekulare edhe kishtarë që përfshijnë një përqindje mjaft të madhe të tërës opusit të tij krijues.

Pra, ky krijues, prelat, emër i shquar i muzikës tonë nacionale, u bë simbol i thellësive krijuese në të cilën ndjejmë praninë e temave të larmishme me pasuritë emocionale, duke krijuar një imazh të vërtetë dhe kështu bëhet figurë qendrore e muzikës në Shqipëri në vitet 1910-1940 deri atëherë kur shkon në amshim dhe varrosët në Shkodër më 3 shkurt të vitit 1940.

Atë Martin Gjoka, konsid-

tër tërë. Kurse Lec Kurti, edhe pse diplomat, kryen në Pesaro kompozimin dhe krijon ca vepra të rëndësishme. Mirëpo me Atë Martinin dhe ca të tjerë, krijimtaria muzikore merr përmasa serioze, duke hapur shtigje të reja me premisa të muzikës bashkëkohore evropiane, që është e kuptueshme, sepse është shkolluar në një qendër të njohur muzikore, siç është Salzburgu në Austrisë, vendlindja e Mozartit.

Edhe pse i lindur në Tivar të Malit të Zi më 20 prill të vitit 1890, ai tërë veprimtarinë e tij e zhvillon në Shkodër, që nga shkollimi e deri në vdekje, me një

“ Atë Martin Gjoka, konsiderohet si njëri ndër kompozitorët e parë dhe të rëndësishëm shqiptarë që i dha një kahe të re krijimtarisë muzikore profesionale, e cila deri atëherë ka qenë në rrugën e zhvillimit dhe e prirë nga shumë kompozitorë autodidaktë si ishte Palok Kurti dhe të tjerë. Ai po ashtu është krijuesi i pari që i rreket muzikës kishtarë katolike me seriozitet. Pas tij vazhduan të tjerët, por jo edhe me aq intensitet dhe përkushtim si ky. ”



Atë Martin Gjoka

erohet si njëri ndër kompozitorët e parë dhe të rëndësishëm shqiptarë që i dha një kahe të re krijimtarisë muzikore profesionale, e cila deri atëherë ka qenë në rrugën e zhvillimit dhe e prirë nga shumë kompozitorë autodidaktë si ishte Palok Kurti dhe

ndarje kur shkon të studiojë në Austri. Hapat a para në muzikë i merr në Gjymnazin Françeskan të Shkodrës, kurse më vonë mëson muzikë te Palok Kurti dhe Frano Ndoja, të cilët e mësojnë jo vetëm piano, por edhe violinë dhe flautë.

Pas një kohe shkon për të studiuar teologjinë në Salzburg, ku pos mësimve fetare, studioi edhe muzikën te profesori Hartmann dhe me të merr mësimet e para nga kompozimi. Mu këtu krijohen pinjollët e parë të pjesëve të vogla muzikore për instrumentet e llojllojshme.

Nuk e zgjeron diturinë vetëm nga muzika-kompozimi dhe instrumentet, por ai atje kupton se marrëdhëniet e artit me jetën e përditshme janë mjaft komplekse, ku shumë faktorë janë pjesëtarë për një kuptim të drejtë, duke i ofruar botën magjike të artit, botë e cila bëhet pjesë e pandarë e jetës së tij.

Realizimet muzikore, instinkti, dhuntia, e udhëheqin fatin e tij, kurse muzika si pjesë e saj bëhet eksperiencia krijuese jetësore. Në qoftë se analizojmë përciptazi pikënisjen e të kompozuarit, do të vërejmë se hasim në imazhe ku perceptohet logjika e krijimtarisë dhe ku procedohet ndjenjësimi i krijimit, duke e shtrirë substancën si element cilësor në veprat e veta. E cila është substanca në veprat e tij? Pa dyshim se është melosi shkodoran, si karakteristikë e tërë një plejade të kompozitorëve shqiptarë, të cilët në veprat e veta përdorin këtë melos. Nëse me kujdes analizojmë këto vepra të Atë Martin Gjokës, për të cilin Dr. Eno Koço thotë se "është një figurë e rëndësishme e muzikës së kultivuar...", do të shohim se kemi të bëjmë me një tematikë të larmishme, duke filluar që nga veprat shekulare-laike e deri te ato sakrale-kishtarë që paraqesin një shumësi të konsiderueshme. Përdorin këtë melos me mjeshtri dhe nuk hasim në ilaritet folklorik si surrogat i artit të realizimit skematik socialist, i cili ka qenë një servilizëm banal dhe të cilin art e ka bërë kushdo, pa dhënë vlera, siç ka qenë muzika e viteve të diktaturës.

Me qenë se do të bëjmë fjalë për këtë të dytën, me plot të drejtë këtë kompozitor mund ta radhitim në krijuesin më të madh të kësaj muzike ndër ata të pakët të asaj kohe. Ndër veprat skenike "Juda Makabej",

opera, teksti i Atë Gjergj Fishtës OFM, v. 1915-1919, e pa mbaruar; "Shqyptarja e qytetnueme", opera, libreti po ashtu Atë Gjergj Fishta pas 1929, ekzistojnë vetëm skicat; ndër veprat vokale duhet të dallojmë "In honorem Navitatis BMV", opus 9, v. 1913; "Meshë" për ATB dhe org. v. 1913; "Requiem" për SATB dhe harmonim, v. 1914; "Da pacem Domine" për alt, bariton dhe harmonim, v. 1915; "In Honorem BMV matris boni consilli", A, B harmonim, v. 1915; "Refugium peccatorum BMV" dhe harmonim, v. 1915; "In solemnitate immaculatoe conceptionis", SATB dhe harmonim, v. 1915; "Meshë" në mi minor, SATB dhe harmonim, v. 1918; "Auxilium Christianorum", A, bar, dhe harmonim, v. 1937; "Dominicalis se cunda, mater amabilis", per A, T dhe harmonim; "In honorem St. Antonii de Padua", në mi minore, për katër zëra dhe harmonim; "In honorem andohet ndjenjësimi i krijimit, duke e shtrirë substancën si element cilësor në veprat e veta. E cila është substanca në veprat e tij? Pa dyshim se është melosi shkodoran, si karakteristikë e tërë një plejade të kompozitorëve shqiptarë, të cilët në veprat e veta përdorin këtë melos. Nëse me kujdes analizojmë këto vepra të Atë Martin Gjokës, për të cilin Dr. Eno Koço thotë se "është një figurë e rëndësishme e muzikës së kultivuar...", do të shohim se kemi të bëjmë me një tematikë të larmishme, duke filluar që nga veprat shekulare-laike e deri te ato sakrale-kishtarë që paraqesin një shumësi të konsiderueshme. Përdorin këtë melos me mjeshtri dhe nuk hasim në ilaritet folklorik si surrogat i artit të realizimit skematik socialist, i cili ka qenë një servilizëm banal dhe të cilin art e ka bërë kushdo, pa dhënë vlera, siç ka qenë muzika e viteve të diktaturës.

Çka mund të vërejmë në këto vepra, pos frymës së re dhe aktualitetit? Natyrisht që flasin për atë kohë; edhe pse edhe ai është bazuar në një skolasitikë standarde të ndikuar nga vetë profesori, megjithatë në mund vërejmë në ca vepra të tij elementet e muzikës së kohës, por jo në atë masë, sepse ajo ka qenë e vëllimeve të reja në muzikë me përfaqësuesit më eminentë të pesëdh-



“ Te Atë Martin Gjoka kemi një muzikë me një sens të devotshmërisë në të tingëlluar muzikor, ku preokupimet artistike të autorit marrin përmasa kuptimore të orientuara jo në kanonet e muzikës klasike, por në ato që i përfaqesin botës imagjinative të autorit me melodi të mahnitshme, i cili percepton edhe frymën e muzikës tonë kombëtare, kurse akti estetik në shumë krijime të tij është plotësisht në ndërlidhje me kohën.

jetëvetëshit të parë shekullit të njëzet, siç janë Leosh Janaçek, Klod Debisi, Jan Sibelius, Moris Ravel, Ralf Vaughan Williams, Bela Bartok, Igor Stravinski, Sergej Prokofjev, Paul Hindemiti dhe disa të tjerë që krijonin në baza të elementeve të muzikës popullore, por edhe të tendencave të tjera. Kurse te Atë Martin Gjoka kemi një muzikë me një sens të devotshmërisë në të tingëlluar muzikor, ku preokupimet artistike të autorit marrin përmasa kuptimore të orientuara jo në kanonet e muzikës klasike, por në ato që i përfaqesin botës imagjinative të autorit me melodi të mahnitshme, i cili percepton edhe frymën e muzikës tonë kombëtare, kurse akti estetik në shumë krijime të tij është plotësisht në ndërlidhje me kohën.

Ka mendime të shprehura në shumë shkrime për këtë autor të spikatur, se autori në kërkimet e veta shpreh drejt dhe në mënyrë objektive jo vetëm formën, ta quajmë “klasike”, por edhe trashëgiminë e pasur muzikore, si kusht i domosdoshëm për të vlerësuar pasurinë e begatshme melodike-ritmike të folklorit tonë, edhe pse kritika e thukët dhe e gjithanshme bazuar në kanonet muzikologjike nuk e ka dhënë vlerën e vërtetë të veprës së këtij krijuesi të spikatur.

Pra, ky krijues është i pari që i rreket muzikës kishtarë katolike me seriozitet dhe pas tij vazhduan të tjerët por jo edhe me aq intensitet dhe përkushtim si ky.

Le të shprehim se muzika sakrale në gjuhën shqipe do të krijohet në të ardhmen dhe do të zërrë vendin e merituar në mbarë krijimtarinë muzikore shqiptare si pjesë integrale e tërë krijimtarisë muzikore.

Partneriteti Kundër trafikimit me qenie njerëzore-PATH

Dinjiteti i personit njerëzor në doktrinën e Kishës

Në kuadër të projekteve të shumta, të cilat implementohen nga Caritasi i Kosovës, gjithashtu bën pjesë edhe projekti “Partneriteti Kundër trafikimit me qenie njerëzore-PATH”, i cili përkrahët financiarisht nga Caritasi Francez, USAID dhe CRS. Më 29 nëntor 2007 në Teatrin Kombëtar, Rrejtji Rinor i Motrave të Mëshirshme të Shën Kryqit ka organizuar programin edukativo-kulturor në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore. Në fillimin e këtij programi, fjalën përshëndetëse e morën Motra Paulinë Micakaj - motra Smila dhe znj. Allison Smith, drejtoreshë e projektit PATH në CRS. Ndërsa në emër të Caritasit të Kosovës, të pranishmëve iu drejtua drejtori i Caritasit të Kosovës, Don Viktor Sopi, i cili konceptoi dinjitetin e personit sipas doktrinës kishtarë dhe njëherësh bëri hapjen e aktiviteteve nga Rrejtji Rinor i Motrave të Mëshirshme të Shën Kryqit për luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore.

■ SHKRUAN:
Don Viktor Sopi

Meqë jeta e njeriut (të gjithë njerëzit) ka një burim – Hyjin, ne mes veti jemi vëllezër. Nga ky fakt, Kisha Katolike, që nga fillimi ka nxjerrë parimin e paluhatshëm të saj, se askush dhe në asnjë mënyrë nuk ka të drejtë të manipulojë me jetën e tjetërkujt. Këtë të drejtë për të qenë i mbrojtur dhe i sigurt, duhet gëzuar çdo person duke filluar nga të ngjizurit e tij.

Kështu, çdo lloj manipulimi me qenie njerëzore nuk mund të gjëjë arsyetimin, as të trajtohet ndryshe, përveç se të cilësohet si krim i rëndë kundër njerëzimit. Askujt nuk i lejohet, askush nuk mund ta uzurpojë të drejtën për të çuar dorë mbi jetën e tjetërkujt. Kuptohet, se kur të flitet për personin njerëzor, automatikisht nënkuptohet dhe flitet për dinjitetin e tij dhe të drejtat elementare të tij.

Dokumentet zyrtare të Kishës Katolike

Parimin për respektimin e dinjitetit njerëzor e gjejmë në faqet e para të Biblës, ku lexojmë se Hyji e ka krijuar njeriun në përngjasimin e vet (krah. Zan 1,27). T’i përngjash Hyjit, do të thotë të jesh autonom, të gëzosh lirinë e plotë, ndërsa për ta jetësuar, apo për ta ndërtuar lirinë e plotë, lipset që njeriu të lirohet nga format e ndryshme të skllavërisë shpirtërore. Vetëm duke jetuar në lirinë e shpirtit ne mund ta vlerësojmë jetën tonë dhe jetën e të tjerëve.

Baza e të drejtave funda-

mentale të personit buron nga dëshira e vetë Zotit. Andaj në Ps 8 mësojmë se Hyji e ka bërë njeriun: “pak më të vogël se engjëjt, e ka kurorëzuar me lavdi e shkëlqim, duke ia dhënë pushtetin mbi veprat e durave të tij dhe duke i vënë gjithçka nën këmbët e tij”. Kështu, pra, madhëria e njeriut dhe e të drejtave të tij nuk qëndrojnë në asnjë fakt tjetër, përveç se në atë që Hyji ia ka falë çdo personit, duke e ftuar në jetë si të tillë.

Nga këto parime dalin dokumentet kishtarë, përsiatjet e mendimtarëve, si dhe baza e qeverive demokratike kundruall të drejtave njerëzore. Dokumentet më zyrtare që debatojnë çështjen e dinjitetit të personit, janë: Enciklika “Pacem I terris” (Paqa në tokë), e Gjonit XXIII, Kushtetuta e Konicilit II të Vatikanit “Gaudium et spes” (Gëzimi dhe shpresa) dhe deklarata “Dignitates humanae” (Dinjiteti i personit), si dhe Katekizmi i Kishës Katolike i vitit 1992, i cili i kushton mjaft hapësirë dinjitetit të personit.

Papa Gjon Pali II në Enciklikën e tij të vitit 1993, “Veritatis splendor” (Shkëlqimi i së vërtetës) në numrin 48 flet për unitetin e personit mes trupit dhe shpirtit duke përbërë një realitet unik – personin dhe unitetin e tij të pacenueshëm. Në këtë vështrim, porosit Shën Pali Apostull se njeriu duhet konsideruar trupin e vet si “banesë të shpirtit të Shenjtë” (khs. 1 Kor 6,



19-20). Guardini shkruan se të jesh person njerëzor, do të thotë se nuk guxon të manipulolesh nga askush, nuk guxon të keqpërdosh, të nënçmohesh dhe as të cenohesh në të drejtat fundamentale. Kështu, Deklarata e Përgjithshme e OKB-së për të Drejtat e Njeriut që në artikullin 1, shpreh admirimin ndaj dinjitetit të personit duke apeluar në respektimin e të drejtave elementare të çdo personi pa dallim gjinie, race, religjioni etj.

Aplikimi

Nga dinjiteti i pacenuar njerëzor, dalin edhe obligimet e çdo personi për ta respektuar njerëzinë, dinjitetin e çdo personi tjetër, për ta mbrojtur dhuratën e jetës tek të tjerët, për ta promovuar lirinë dhe prosperitetin njerëzor në forma të ndryshme, pjesë e së cilës fushatë është edhe Caritasi, që mundohet të japë kontributin e vet. Duke nderuar dhe mbrojtur dinjitetin njerëzor tek


të pafuqishmit dhe tek të pambrojturit, ne njëherit mbrojmë dhe nderojmë jo vetëm urdhrin e Hyjit, por edhe nderin dhe dinjitetin tonë personal.

Të drejtat e personit nuk janë dhuratë as e Caritasit dhe as e qeverive demokratike apo e pushtetarëve të fuqishëm dhe as e shteteve përparimtare; madhëria e dinjitetit të personit dhe të drejtat e tij qëndrojnë në natyrën e çdo personi. Qeveritë dhe të gjithë faktorët relevantë duhet t’i njohin dhe t’i respektojnë ato.

Secili prej nesh është i ftuar dhe i obliguar që ta mbrojë jetën njerëzore, ta kultivojë atë dhe të krijojë ambiente të përshtatshme për avancimin e saj në të gjitha sferat e jetës. Nuk mund të presim që të jemi të respektuar nga të tjerët, nëse nuk bëjmë asgjë për t’u respektuar dhe për t’i nderuar personat rreth nesh, posaçërisht ata që kanë më shumë nevojë për ne.


Përfundim

Në doktrinën e mesazhin e krishterë, jeta njerëzore apo dinjiteti i personit është i pacenueshëm në të drejtat e tij fundamentale. Jeta e secilin njeri paraqet dhuratë të veçantë të Hyjit, është një ftesë e tij personale për secilin prej nesh. Hyji si burim i jetës, nga Jeta e vet, ne na ka falur jetën dhe vetëm njeriu i ka vetitë, komponentët e vetë Hyjit, me të cilat vlera ne i tejkalojmë të gjitha krijesat tjera.



Jam mik i Kishës Katolike dhe dua ta ndihmoj ndërtimin e Katedrales "Nëna Terezë" në Prishtinë!

Gjithë juve miq dhe bamirës të dashur ju mundësojmë ta jepni kontributin përmes xhironlogarive bankare. **Faleminderit!**

 **Raiffeisen BANK**
Kosovo J.S.C.
Prishtina, Kosovo
SWIFT code: RBKORS22

Adm. Ap. e Prizrenit
Numri i llogarisë:
EUR: 1501 090000 1990 20
USD: 1501 090000 3765 30
CHF: 1501 090000 3764 33

Valuta	Banka	Shteti	SWIFT/BIC
EUR	Raiffeisen Zentralbank Oesterreich AG	Vienna, Austria	RZBAATWW
USD	American Express Bank, LTD	New York, US	AEIBUS33
CHF	UBS AG	Zurich, CH	UBSWCHZH80A